

GRANIT ZELA dhe FLURANS ILIA, janë shfaqur në rrethet letrare dhe në shtypin letrar në fillim të viteve 2000. Kanë botuar libra me poezi dhe prozë duke tërhequr vëmendjen e kritikës dhe të kolegëve të tyre. Janë të pranishëm shpesh në shtypin shqiptar, brenda dhe jashtë vendit, me shkrimet e tyre në lëmin e publicistikës, esesë, përkthimit dhe studimit. Ashtu si shumë krijues, që janë larg atdheut gjeografik, ky dialog i gjallë i bashkon në atdheun letrar për të rrëfyer fillimet, rrugëtimin krijues dhe artin e fjalës së shkruar.



## GRANIT ZELA FLURANS ILIA

### SHKRIMTARI JETON ME ATË QË NDODH NË ATDHEUN E TIJ



### Gurëthemet historike të një romani nga Mira Meksi (fq. 14)

Përherë kam dëshiruar të shkruaj një roman për Teutën e Ilirisë. Fillesat kanë qenë prej një pasioni të hershëm të fëmijërisë për "mbretëreshën luftëtare", pasion që sigurisht ishte rritur me kalimin e viteve, duke u bërë më i plotë dhe më i pasur. Pasioni ishte ushqyer nga një mjegullinë misteri që e vishte Teutën: në librat për fëmijë dhe në shkollë mësonim se ishte mbretëresha legjendare e ilirëve...



### KISHA E SHËN SOFISË

Tregim  
Nga Ismail Kadare

Vezirët po zgjoheshin njëri pas tjetrit. Meqenëse asnjëherë nuk ishin gdhirë aq pranë (shatorrja e ministrit të Luftës ishte pothuaj ngjitur me atë të ministrit të Punëve të Jashtme, dhe kjo e fundit dy hapa larg nga shatorrja e vezirit të madh, çka e bënte edhe më të rrokshëm shkallëzimin), pritej që, si në çdo shtet të përsosur, ata të ngriheshin nga gjumi sipas shkallës hierarkike...

(fq. 8)

### Njëzet e një mjeshtra për procesin krijues

Clavel • Llosa • Barthes • Rilke  
• Echenoz • Fitzgerald • Jacob •  
Lodge • Butor • Green • Laurent •  
Sabatier • Sarraute • Baudelaire  
• Marquez • Bot • Gracq • Clavel •  
Michelet • Baudelaire

(fq. 18)

### EDUARDO GALEANO Pse shkruaj

(fq. 16)(fq. 17)

### T. TRANSTRÖMER Kujtimi im i parë

### Mbi disa qenësi të poezisë së Frederik Rreshpjes Imazhi poetik si qenësi e poezisë, e komunikimit dhe e ndikimit artistik

Nga Anton Nikë Berisha

Në ligjëratat rreth stilistikës të shkallës së tretë në Fakultetin filozofik të Universitetit të Zagrebit, prof. Krunosllav Pranjiq, ndodhte të na sillte një tekst të një poezie të një poeti të shquar...

(fq. 6)

### BIBLIOTEKË

Andrin Kabashi

*Vrasja e T. Ivan  
Ivanoviçit*

(fq. 9)

Roland Gjoza

*Gruaja me  
ombrellë të verdhë*

(fq. 10)

Istref Haxhillari

*Gruaja e ëndërrt*

(fq. 11)

### GJUHA E NATYRËS, NË NJË SERI TË VEÇANTË LIBRASH PËR FËMIJË

(fq. 5)

### Vazhdimësi dhe risi në vëllimin "Paralele dhe kryqëzime" të Klara Kodrës

nga Hasan Gremi

(fq. 15)

GRANIT ZELA dhe FLURANS ILIA, janë shfaqur në rrethet letrare dhe në shtypin letrar në fillim të viteve 2000. Kanë botuar libra me poezi dhe prozë duke tërhequr vëmendjen e kritikës dhe të kolegëve të tyre. Janë të pranishëm shpesh në shtypin shqiptar, brenda dhe jashtë vendit, me shkrimet e tyre në lëmin e publicistikës, esesë, përkthimit dhe studimit.

Ashtu si shumë krijues, që janë larg atdheut gjeografik, ky dialog i gjallë i bashkon në atdheun letrar për të rrëfyer fillimet, rrugëtimin krijues dhe artin e fjalës së shkruar.

# GRANIT ZELA FLURANS ILIA

## SHKRIMTARI JETON ME ATË QË NDODH NË ATDHEUN E TIJ

**Granit Zela:** I dashur Flurans! Herën e fundit që jemi takuar ka qenë tetor 2011, te qoshku “E për7shme”, ku ti kishe një mbrëmje leximi. Atë mbrëmje m’u desh të largohem nga fundi i takimit dhe të lashë në atë qoshk- ishullth, në detin e trazuar të rrugëve ku gjithnjë e më pak ka vend për letërsinë dhe artin e fjalës së shkruar. Sa ka pasur dhe ka jetë letrare në vendin tonë?

**Flurans Ilia:** Isha i ftuar nga Agroni dhe Elvana në atë bisedë te qoshku i librave, “E për7shme”, për gjëra të cilat i kemi dashur, bashkëjetojmë, me to do të vdesim një ditë. Është bukur kur jeton me Librin, jo sepse aty janë depozituar disa nga pyetje-përgjigjet më ekzistenciale të njeriut, por sepse nëpërmjet tij na jepet mundësia të kuptojmë horizontin, të jetojmë bukur, përtej vdekjeve si kufij ndarës. Ndodhesha me pushime në atdhe atë vit, me shumë mall për njerëzit, për gjëra që na përkasin dhe i konsideroj të shenjta. Papritur nëna ime u sëmur rëndë dhe gjithçka u rrokullis rrokapjekthi, nga një realitet turisti me aparat fotografik, në një përpjekje mbinatyrore për të fiksuar nën fokus absurdin e realitetit shqiptar. M’u desh të anulohet kthimin në Montreal, t’i përkushtohem nënës në spital, e cila në kllapi më thoshte: “Mos më lër vetëm!” Sot, kur gjërat dhe koha tkurren pak e nga pak, i them shpesh letërsisë: “Mos më lër vetëm!” Kërkimi dhe gjetja e një qoshku për Librin është si puna e oazës, kur etja bëhet e padurueshme. Si puna e besimtarit që beson në Zot dhe jo në dogmën institucionale. Si i sëmuri që sheh te mjeku shenjtinë e njeriut fisnik dhe jo harbutërinë e një haraçmbledhësi. Besoj, gjithkush e ka një qoshk brenda dhe jashtë vetes. Në fillimet e mia veçoj “Haemus” dhe “Fjala”, të cilat më kanë mbështetur dhe u jam mirënjohës. Në internet përpara epokës Facebook & Twitter, “Krizantem” dhe “Ars Poetica”. Më kujtohet dimri i vitit 2005 kur Ervini sapo e kishte krijuar qoshkun e librave “E për7shme”. Ato takimet e para aty me “poetët e së mërkurës” ishin si oazë në mesin e javës, në vorbullën e një Tirane të zhurmshme dhe shpesh absurde. Kjo më ka ngulur në kujtesë si *underground* ku gjallonte njëra nga jetët letrare të atyre viteve, larg ndriçuesve të lokaleve të “Bllokut”. Aty u takova me Ervin Hatibin, Agron Tufën, Besnik Mustafajn, Ukzenel Buçpapajn, Fatmir Baçin, Granitin etj. Pastaj erdhi “Poeteka”. Ishte njësoj

si të dilje në det të hapur. U njoha nga afër me Ali Podrimjen, Xhevahir Spahiun, Zija Çelën, Arjan Lekën, Anton Paplekën, Primo Shllakun, Pano Taçin etj. Gati pesëmbëdhjetë vjet më vonë, të gjitha këto më vijnë në mendje si jehona letrare të cilat tingëllojnë pranë. Njësoj si zilkat e celularëve ku prej një kohe të gjatë të merr malli për pak zë. Me të vetmin ndryshim, sot në internetin e pamat të komunikimit me Tjetrin mund të shihesh, të shtresh, të fjalosesh, të lajkosesh, të lexohesh, të tërbohesh nga ekrani i rrjeteve sociale. E djeshmja është një bllok shënimesh prej lëkure i kaluar dorë më dorë. E mërkura përngjan si det pa brigje. Dua

të them, në vendin tonë ka pasur dhe do të ketë jetë letrare, ato janë si ata rrathët e krijuar në kujtesën e sipërfaqes së ujit, i përkasin njeriut pra, kujtimeve që bëhen brigje. Jam një personazh me fat që bëj pjesë në këtë rrëfenjë. Ndiem si ai remtari i panjohur që përpiqet ta shtyjë pavetëdijën e vet drejt vetëdijes së përbashkët. Më kujtohet si tani kur në një nga ato net të qoshkut, me pezëm poetik dhe vështrim të kthjellët, ti konstatove papritur: “Ne jemi shkrimtarë të territ!” Pas gjithë këtyre viteve, përvojave, arritjeve, mbijetesës, si e shikon ti, Granit, terrinën ku baret Libri? A lexohet në këtë atdheun tonë të vogël prej letre?

**G. Zela:** Unë jam bërë lexues, sepse kam pasur në shtëpinë time të fëmijërisë një bibliotekë që e kishte krijuar im atë që në fillim të karrierës së tij si mësues i *lëndës së leximit*. Pyes veten, sa familje të reja, të brezave pas nëntëdhjetës, kanë në shtëpitë e tyre një bibliotekë? Kjo është e lidhur me përgjigjen që po kërkojmë. Së dyti, mbaj mend klubin e krijuesve letrarë që në shkollën tetëvjeçare. Në shkollë të mesme librat i merrja nga biblioteka e shkollës “Shejnaze Juka”, por edhe nga biblioteka e qytetit, më pas nga biblioteka e fakultetit në Tiranë, por edhe nga Biblioteka Kombëtare. Dua të them se pyetja sa lexohet ka lidhje me atë se sa arrin shkolla ta rrënjosë zakonet e leximit dhe cili është roli i këtyre bibliotekave sot. Nuk e di se sa është rrënjosur fuqia magjepsëse e artit të fjalës së shkruar te zakonet dhe shijet e leximit në epokën digjitale. Letërsia nuk është më lëndë e veçantë, kurse testi i letërsisë për maturën 2020 më ngjan si kabanë që bie për ata që duan të dëgjojnë. Rady Bradbury ka shkruar se nuk është e nevojshme të djegësh libra për ta shkatërruar një kulturë, kjo ndodh kur njerëzit thjesht reshtin së lexuari. Për të kaluar te procesi i shkrimit, Emily Temple, kryeredaktore e një reviste letrare elektronike, ka shkruar një shkrim mbi romanin pas-pandemik. Ky shkrim është si reagim ndaj atij të Sloane Crosley-t, botuar në *The New York Times* me titull “Një ditë do të kujtojmë gjithçka dhe do të shkruajmë një roman”. Mua më trazon cilësimi “Libri i karantinës”. Në të vërtetë, karantina, murtaja dhe çdolloj hataje mund të kthehet në lëndë të parë për Librin, ato janë të tij dhe nuk është Libri i tyre. Kjo ishte shtysa nxitëse për ta përkthyer, si për ta zgjeruar pak debatin.





**F. Ilia:** I lexova të dyja shkrimet dhe e kam ndjekur replikën në fjalë, si brenda edhe jashtë vendit. Temë aktuale. Pse e them këtë? Sepse natyra njerëzore, sidomos shkrimtari, mënyra se si ai e përthith dhe e ndjell rrahjen ritmike të situatave të tilla, nuk është kaq bardhezi, përkundrazi, është një fidanishte shumë më e ndërlikuar sesa vetë arratia e një copë ADN-je. Të paktën në një gjë jemi të bindur. Romanet e epokave të përmendura të shkrimet nuk janë shkruar katërçipërisht për Luftën e Parë, të Dytë, 9/11, apo aktualisht për COVID-19. Më gjerë se kaq, këto vepra janë munduar të eksplorojnë njeriun nëpërmjet dhe përtej situatës. Nuk jam dakord që të mos shkruhet për dhe përgjatë kësaj kohe pandemike. Dhe jam pjesëmarrjes në këtë sfidë. Mendoj se është një shtysë e mirë për cilindo krijues. Sidomos për të rinjtë. Por, jam plotësisht në akord me faktin që vlera e këtyre romaneve do të jetë e dukshme ose e zbehtë 20 vjet më vonë, nëse dalim ashtu si duhet nga kjo pandemi. Meqë jemi brenda temës, dua të shtoj se “Murtaja” e Kamysë dhe “Verbimi” i Saramagos janë romane të pamposhtura në llojin e vet. Sikur shkrimtari i karantinës do t’i avitej me po aq kthjelltësi ngrehinës të këtyre dy romaneve, për mua do të ishte jo sfidë, por bindje se letërsia ngelet arti i njeriut. Ti si mendon?

**G. Zela:** Po, janë shembuj të shkëlqyer. Në fund të fundit, Kamy dhe Saramago shkruajnë një vepër letrare të gjendjeve të skajshme, për kërcënimin e jetës, humbjen, traumën, frikën, duke krijuar analogji me ngjarje historike të shkatërrimit në masë që ka përjetuar bota njerëzore. “Ditari i murtajës” i Daniel Defos, histori e trilluar e ngjarjeve në Londrën e vitit

1665, viti i shpërthimit të fundit të murtajës epidemike në Anglisë, la shenjë të Kamyja, murtaja imagjinare e të cilit shpërthen gjatë dekadës së trazuar të viteve 1940 në Algjerinë franceze. Nga ana tjetër, “Verbëria” zbulon natyrën e realiteteve shoqërore, ekzistencën e egër tejet të brishtë, e cila varet nga fakte që mund të zhduken çdo çast duke hulumtuar sjelljen morale dhe politike, me një thellësi më të madhe filozofike. Matanë kësaj tronditjeje shpirtërore mbarëbotërore shkrimtarët e mirë do të vijojnë të shkruajnë mirë. Kur kjo të ketë mbaruar, fjalët “karantinë” dhe “pandemi” s’do të kenë peshën që kanë sot. Sërish, si gjithmonë, krijuesi do të përballet me COVID-in e vetes, dramë brenda tij në marrëdhënie me kujtesën individuale dhe kolektive etj. Në fund fare, pandemia nuk ndikon në cilësinë e shkrimit. Kurse për kohën e shkrimit të një veprë ajo përcaktohet nga urdhri i brendshëm krijues.

**F. Ilia:** Absolutisht! Kjo më sjell në mendje William Faulkner-in dhe veprën e tij. Vdekja tragjike e George Floyd-it në turpin dhe trupin amerikan të këtyre ditëve më gjeti të zhytur në thellësinë e romanit “Dritë e gushtit”. Nuk ka një të dytë në letërsinë amerikane dhe të përbotshme që t’i ketë hyrë gjer në kockën analitike problemit të gjithmotshtëm amerikan me forcën universale të një gjeniu si Faulkner. Po të reflektojmë një çast, romani është publikuar në vitin 1932 dhe ngelet kaq aktual. Ndërkohë, jam duke studiuar me laps në dorë “Duke dhënë shpirt” për t’u familjarizuar me strukturën e brendshme dhe arkitekturën fenomenale të këtij autori. Autori pretendon ta ketë shkruar romanin në gjashtë javë pa ndryshuar asnjë fjalë të vetme. E botoi në vitin 1930. Gati nëntëdhjetë vjet më

vonë, të dyja këto romane të Faulkner-it vijnë në shqip (Botimet Onufri) të përkthyer nga ti, që ke bërë një përpjekje titanike. Urime dhe respekt për punën tënde! Cilat janë sfidat e përkthimit të autorëve të këtyre përmasave në shqip?

**G. Zela:** Së pari, duhet të të pohoj se nuk kam menduar ndonjëherë që do ta përktheja Folknerin. Historia ime me këtë autor lidhet me vitet universitare, kur pas diskutimit të romanit “Duke dhënë shpirt” në fakultet vendosa që në të ardhmen të ndiqja studimet master dhe doktoraturë me këtë autor, pasi ndoshta do të më ndihmonte si krijues. Folkneri dhe Edgar Allan Poe ishin dy shkrimtarët që më lanë përshtypje të thellë në universitet. Gjatë një kursi katërmujor studimi të gjuhës angleze në Houston, Teksas (2004), bleva të gjitha romanet e Folknerit. Pas kthimit, shkrova një studim të shkurtër që mund të ishte thelbi i mikrotezës, por, kur shkova me punimin në dorë në fakultet, pranimet sapo kishin mbaruar dhe isha vonë. Vitin tjetër studimin e këtij autori e kishte marrë përsipër dikush tjetër, kështu që nisa studimin e Donald Barthelm-it, autor postmodernist. Ndërkohë, pjesë të studimit dhe përkthime të ndryshme i botova në gazetën “Fjala” të Agron Tufës. Ishte Agroni që në verën e vitit 2009 më nxiti të përkthej “Dritë e gushtit”. Atë vjeshtë shkova në Teksas për herë të dytë me studime, kësaj radhe për dy muaj, dhe e pashë romanin për herë të parë me syrin e përkthyesit. M’u kujtua ajo që kisha ngulitur në mendje në fakultet: “Ah, Folkneri, i papërkthyeshem.” Për çudi, mu në paragrafin e parë, ishte një shprehje e Linda Grouv që s’po e gjeja as në fjalor. E pyeta pedagogen time të gjuhës angleze çfarë do të thotë shprehja “It’s a fur piece” dhe ajo, pasi mendohet, më thotë: “I don’t know!” Për më tepër, disa paragrafë ishin shumë të gjatë, me mbiemra të njëpasnjëshëm që ngjisheshin në fjali, kurse mua më binin si grushte në fytyrë... Epo, thashë me vete, kjo nuk u bëka. Pas kthimit, i shkrova një mesazh Agronit duke i thënë se ishte e pamundur ta përktheja, ndërsa ai më kthen përgjigjen spektakolare: “I dashur, Granit, asgjë nuk bëhet pa sakrificë. Tani që po të shkruaj është ora një e natës dhe jam duke përkthyer. Jam i sigurt që do ta përkthesh. Do të të ndihmoj unë për botimin.” Kështu, kuptova se nuk mund ta shmangia më dhe duhej ta bëja, më në fund, “doktoraturën” për Folknerin. Gjatë viteve të mëpasshme grumbullova vazhdimisht materiale për autorin, biografi, monografi, qindra artikuj studimorë (një pjesë i kisha gjetur në librarinë e Houston-it), përkthime në gjuhë të tjera, analiza kritike, komantarë dhe sidomos studime mbi përkthimet dhe zgjedhjet e papërshtatshme që kishin bërë përkthyesit. Përkthimin e nisa në dhjetor 2014 dhe pasi përktheva gjysmën e librit, vitin tjetër e ndërpreva për pak kohë. Në njëfarë mënyre, s’po e besoja që po e përktheja “të papërkthyeshem”, prandaj, për të bindur veten, u mora për një muaj me ripërkthimin e “Korbit”, poemës së Edgar Allan Poe-së. Në mars 2016 i shkrova Agronit duke e lajmëruar se pothuajse e kisha mbaruar përkthimin e romanit, po merresha me kapitullin e fundit dhe tani më duhej ndihma e tij për botimin. Agroni më lidhi me botuesin e Onufrit. Dua t’i shpreh mirënjohjen time publike Agronit për nxitjen, besimin dhe angazhimin për ta parë të botuar romanin “Dritë e gushtit”. Botuesi Bujar Hudhri e çoi këtë projekt edhe më tej duke marrë të drejtat e autorit për dy romanet e tjera, “Duke dhënë shpirt” dhe “Absalom, Absalom!” dhe kjo për mua ishte befasi e vërtetë.


Disa nga sfidat e përkthimit janë sfida me të cilat përkthyesit përballen gjithmonë gjatë përkthimit të veprave të vështira. Te Folkneri janë: fjalori, fjalëkrijimet, fjalët e përbëra, fjalët me ngjyresa kuptimore që s’e kanë një barasvlerës në gjuhën pritëse, fjalitë e shtjelluara imtësisht, paragrafët e gjatë, ndryshimi i rrëfimitarëve dhe perspektivës rrëfimtare, përsiatjet me regjistra të larmishëm gjuhësorë që pasqyrojnë rrjedhat e pashqiptuara të mendimit. Ligjërimi i personazheve karakterizohet nga një gjuhë

jokorrekte/ jostandarde, idioma vendase, forma të shkurtuara, struktura mohuese, ngatërrimi i njëjësimit me shumësit, pra, zhargoni i së folurës që tregon shtresën sociale dhe nivelin arsimor të personazheve në qytetë të trilluar të Xhefersonit, në Jokapatofa të Misisipit. Duke marrë parasysh natyrën e përgjithshme të dukurisë së përkthimit, rezultati varet nga zgjedhjet dhe interpretimet e bëra nga përkthyesi. Kam synuar që zgjedhjet të reflektojnë origjinalin duke qenë njëkohësisht sa më të natyrshe për lexuesin shqiptar.

Përkthyesi i parë në frëngjisht, Maurice Edgar Coindreau, përkthimet e të cilit, "Lumiere d'Aout" dhe "Taundis que j'agonise", mund të jesh duke lexuar, e ka njohur personalisht Folknerin. Ai ka shkruar për sfidat e përkthimit në frëngjisht dhe në fund ka arritur në këtë përfundim: "William Faulkner është autor i vështirë dhe rrjedhimisht, nga ata autorë që u jep atyre që e përkthejnë më të madhen kënaqësi, sepse një fitore mund të jetë plotësisht përmbushëse vetëm nëse kundërshtari të bën një sfidë të vërtetë." Kur themi "fitore", nënkuptojmë domethënien kulturore që ka përkthimi i veprave të tilla në letërsinë e një vendi. Borgesi e përktheu në vitin 1940 "Palmat e egra" (*Las palmeras salvajes*) dhe Folkneri, me këtë përkthim dhe të mëpasshmit, u kthye në një nga autorët më me ndikim në botën letrare hispanike. Është përpjekja për të dhënë plotësinë e origjinalit arsyeja pse në vitin 2003 kishim në gjuhën angleze versionin e trembëdhjetë të përkthimit të romanit të vëllimshëm, mbi një mijë faqe, "Don Kishoti". Po kështu, duke theksuar rolin ndikues në letërsinë e vendit ku kryeveprat përkthehen, *The Guardian* doli në vitin 2017 me editorialin "Pikëpamja e *The Guardian* mbi përkthimin: akt interpretues dhe krijues", duke përshëndetur përkthimin e "Odiseja" të Homerit nga Emily Wilson, profesoreshë e letërsisë klasike në Universitetin e Pensilvanisë, pas gjashtëdhjetë përkthimeve të mëparshme. "Përkthimi, - shkruan *The Guardian*, - është gjithmonë një akt interpretimi: akt krijimi që, në të njëjtën kohë, në mënyrë paradoksale, kërkon besnikëri të palëkundur ndaj tekstit origjinal. Ne duhet t'i përkrahim përkthyesit tanë për këto akte të ndrojtura krijimi, këto tradhti besnike. (Të përkthesh do të thotë të tradhtosh, siç është thënia në italisht, *traduttore traditore*.) Përkthyesit janë udhërrëfyesit tanë në kohëra dhe territore të tjera. Ata na nxisin të lëmë brigjet tona letrare dhe të marrim parasysh mënyra të tjera të jetuari, mënyra të tjera të menduari, mënyra të tjera të shprehjes dhe formave artistike. Letërsia e një vendi, e një gjuhe, mund të riformësohet nga përballja me tekste të vendeve të tjera". Po ti, Flurans, ke shkruar gjatë kësaj kohe? Ka ndikuar kjo kohë te koha jote e shkrimit?

**F. Ilia:** Sigurisht, Granit, po më grish kjo bisedë për disa të vërteta që mbart në vetvete. Fillimisht duhet thënë se në situata të tilla nuk është situata që i prodhon në thelb librat. Për më tepër, romanin si mëvetësi. Por është i gjithë bagazhi që ke tërhequr zvarrë gjer këtu. Si të thuash, është ajo që ti JE në përballje me trazirën e përbotshme. Situata në fjalë provokon instinktin. Midis dy alternativave, "vetëvrasjes kolektive" dhe "SHËRBESËS së një libri", në kohë të tillë unë personalisht do të zgjidhja LIBRIN. Nuk ka pikë rëndësie nëse është apo jo libër karantine. Libër antiracial. Apo fantastik. Më e rëndësishmja është që është shkruar në vendin dhe çastin e duhur dhe të ka shërbyer si varkë shpëtimi. Këtë nuk ke se si ta harrosh, qoftë si njeri, por edhe si shkrimtar. Duke folur për veten, e kam mbajtur kokën ulur mbi shkrime gjithë këto ditë dhe i kam anashkaluar qëllimisht indekset e shifrave dekurajuese. Jam i vetëdijshëm, megjithëse libri nuk ka të bëjë në thelb me pandeminë, se nëpërmjet tij do ia dal mbanë të mposht tjetrin brenda vetes, qoftë ky një copë ADN-je e arratisur nga ndonjë epruvetë apo thjesht një virus natyror. Më duhet ta pohoj se, po të mos ishte kjo situatë absurde, asnjëherë nuk do të isha kaq i motivuar

shpirtërisht dhe mendërisht për të shkruar. Dhe me motiv nënkuptoj të dalën matanë territ. Natyrisht, jo të gjithë e perceptojnë situatën njësoj. Gjithsecili përzgjedh format e veta. Nuk jam dakord me "romanin pandemik" si etiketë, e theksoj, ku si temë të jetë vetëm COVID-19. Këtë nuk ma lejon pozicioni si lexues dhe si njohës i mirë i romanit. Por jam absolutisht i hapur me çdo formë tjetër, shkruar, rishkruar, përmbledhur, reduktuar, ripunuar, përgjatë karantinës. Shembulli i William Faulkner-it tregon se një roman i mirë mund të shkruhet edhe në gjashtë javë pa ndryshuar asnjë fjalë. Konstatimi është i njëjtë me shembujt e Kamysë dhe Saramagosit që solla më sipër, pra duhet të jesh William Faulkner për "çudira" të tilla. Kam përshtypjen se tregimi, kjo specie ende e gjallë në zhdukje e sipër, është "vaksina" që i kundërvihet çdo retorikë dhe debati pandemik. Përse e them këtë? Sepse tregimi nga natyra e vet kompakte është si një kundërtrup mjaft efikas për të reaguar ndaj së keqes aty për aty. Shiko tregimet e Kafkës dhe Buxatit, janë melhemi i duhur për të mos u nënshtuar kundrejt çdo rrethimi vicioz sot e mot. Pra, sapo kam përfunduar një përmbledhje me tregime. E gjej dhe shoh veten pranë tregimit këto kohë izolimi nga njëri-tjetri.



**G. Zela:** Më pëlqen ky imazhi i varkës së shpëtimit dhe bagazhit të hequr zvarrë. Sot, për çudi, m'u shfaq sakaq në sytë e mendjes dita e kthimit në vendlindjen time, një fshat në breg të Drinit të Zi, pas ndoshta pesëmbëdhjetë vjetësh. Katundi m'u duk i braktisur, vetja m'u duk i huaj, ata njerëz, fytyra e jehona zërash që e kishin mbushur fëmijërinë, nuk ishin aty, kurse lumi rridhte si gjithmonë, ndërsa unë isha kthyer për t'u larë sërish në të njëjtin lumë, dhe ndoshta m'u kujtua sot se ndjeva një shtysë për të shkruar. Ndoshta kjo është letërsia, një përpjekje për t'u rikthyer te lumi i kujtimeve, përvojave, ndjesive, për t'i rikrijuar, për t'i rijetësuar ose për t'i imagjinuar. Orhan Pamuk thotë diku se ankthi i tij ishte shkrimi dhe të gjitha kujtimeve në formën e një libri. A ndodh kështu me ty?

**F. Ilia:** Fëmijëria ngelet bastioni i fundit që bie te njeriu. Nuk është shpresa. Është fëmijëria. Kur kthehem te fëmijëritë tona, realizojmë në ndërjegje kapërcimin e kohës. Them: sa shpejt ikën koha! Sa



paskan ndryshuar gjërat? Dëshmojmë maturinë e një brezi në raport me prindërit dhe fëmijët tanë. Njerëz që nuk jetojnë më. Detaje, objekte, subjekte, histori, vende, peizazhe të vdekura që papritur rivijnë vrullshëm me një gjallëri të habitshme, duke e tjetërsuar lumin e fëmijërisë sa përmasa shekullore e një çasti. Shiko se çfarë më ndodhi para pak kohe. Jam një njeri që në realitet nuk shoh ëndrra. E kam trurin si pllloçë buzë lumit, shoh ëndrra një herë në pesë vjet ndoshta. Ama kur i shoh, i shoh me "thagmë" apo "llaftarë" do të thoshte Lasgushi. Në dhjetë maj të këtij viti shoh në ëndërr si me qenë i ulur në parmakët e Urës së Goricës në Berat. Nën këmbët e zathura më rridhte Osumi. Mbaja në dorë një vazo nga ato të krematoriumeve brenda së cilës gjendej hiri im. E futa dorën në të dhe me grushte fillova ta hedh hirin tim në lumë. Me atë kureshtjen fëmijore fillova të pyes veten "Si ka mundësi që jam edhe i vdekur edhe i gjallë?", ndërkohë që grimcat e hirit pa prekur ende sipërfaqen e ujit shndërroheshin në germa. U zhvesha (si dikur) dhe u hodha nga ura në lumin e fëmijërisë sime për t'i mbledhur ato germa. Nga kontakti me ujin më doli gjumi. Syhapur po i thosha vetes: "A është i mundur ky imazh? Të mbledhësh hirin apo fjalët në një lumë? Qoftë ky lumi i fëmijërisë apo lumenj të tjerë që ke ndeshur në jetë?" Tingëllon si absurde, por kënaqësia ishte e papërshkrueshme, sinqerisht. Ndoshta këta jemi ne, fëmijë të rritur që kridhen lakuriq në lumin e fëmijërisë?

**G. Zela:** Krijuesi jeton me atë që ndodh në atdheun e lindjes. Lexoj herë pas here reagime tuat për çfarë ndodh në Shqipëri. Një herë ke shkruar: Ju nuk e kuptoni, Shqipëria ka adrenalinë. Çfarë doje të thoshe me këtë? Ke ndryshuar mendim? Do të shtojë ndonjë gjë tjetër përveç adrenalinës?

**F. Ilia:** Po e kam thënë, nuk kam ndryshuar mendim. Vendi ynë ka një adrenalinë dhe dinamikë të përsosur, si rrjedha e lumenjve të tij. Duhet pasur kujdes kur shprehesh në këtë formë, sepse lumenjtë kanë një pjerrtësi të konsiderueshme te ne dhe keqkuptimet janë të shumta. Reagohet në mënyrë sipërfaqësore, reagohet me thikë në kockë, reagohet me inferioritet dhe xhelozitë, me luftë dhe polemikë të ngjyer me ngjyrat e grushteve të politikës, smirës, sjellje dhe etiketime këto për të cilat, me thënë të drejtën, nuk e kam çarë lëvizhjen e arrës për të nxjerrë prej aty ndonjë thelb, jo. Por ama, nga ana tjetër, unë notin e kam mësuar në lumë, miku im. Shqipëria kjo është, aty do të jetë edhe qindra shekuj pas këtyre fjalëve, edhe pas nesh. Me adrenalinën e një nervi rinor të përjetshëm. Me njerëz gjaknxehtë dhe të vrullshëm si të gjithë ballkanasit, aventurierë, prototipa dhe personazhe si ata të realizmit magjik latino-amerikan, kalamaj çapkënë të kapur ndër detaje, histori të trishta dhe përpjekje për t'u ringritur. Ku gjen vend tjetër në Ballkan me tri fe të harmonizuara nën një gjuhë të përbashkët? Unë jetoj më tepër se çerek shekulli jashtë vendit tim. Në një vend idilik për nga pastërtia, gjelbërimi, respekti për ligjin dhe të drejtat e njeriut, sjellja, pjekuria, marrëdhëniet ndërnerëzore, raportet me shtetin dhe pasurinë private, e të tjera veti si këto që duhet të karakterizojnë një vend demokratik. Por të gjitha këto janë të shtresuara si një liqen i ngrirë i mbuluar nga akulli ku nuk ndodh asgjë në kuptimin e nervit lëvizës shqiptar. Shqipëria është thesar me personazhe dhe subjekte lëvizëse si rrymat e rrezikshme dhe vitale nën akull. Aty jetohej më shpejt dhe më vrullshëm, më rrezikshëm dhe pa asnjë lloj sigurie, çka përbën thelbin natyror të vet lëvizjes, dhe kjo është adrenalina për të cilën po rrëfem. Shqipëria ka për të jetuar gjatë në saje të kësaj energjie të pashtershme.

**G. Zela:** Faleminderit, Flurans, për bashkëbisedimin!

**F. Ilia:** Të lutem, Granit, kënaqësia është e përbashkët!



# GJUHA E NATYRËS, NË NJË SERI TË VEÇANTË PËR FËMIJË...

- “Librat e stinës”,  
shkruar e ilustruar  
shumë bukur -

nga Ekleva Progonati

Një nga letërsitë më të vjetra e të panjohura mirë në bibliotekën shqiptare të librit është ajo që vjen nga kultura aziatike dhe në rastin tonë nga kultura kineze. Kur shfleton një letërsi të tillë, që i kalon jo vetëm kufijtë tokësorë, por në radhë të parë të mënyrës së të parit e të vlerësuarit të gjërave njihesh me një botë tjetër imagjinare. Sigurisht, të vendosur në vende e ambiente kineze, pa shumë lule e lajle, thjesht, bukur dhe me artin e fjalës për të lënë mbresë dhe “uri” për të lexuar më shumë nga kjo kulturë.

Kjo është risia më e fundit që vjen për fëmijët nga Shtëpia Botuese DITURIA, e cila këtë herë ka vendosur “të përthithë” kulturë nga një vend i largët, por që nuk duket edhe aq i tillë kur njihesh me shkrimtarët kinezë. DITURIA sjell në vëmendjen e lexuesit shqiptar një frymë të re në kulturën tonë, e cila, edhe pse fort e ndryshme nga e jona, gjen terren dhe mjaft mirë, krenare për faktin se sot lexuesi ynë ka njohur një botë të re. Këto libra janë pa diskutim ndër më të veçantët që mund të keni lexuar ndër vite.

Këtë herë, DITURIA ka zgjedhur e propozuar për lexuesin e vogël që të njohë dhe ta fusë në një botë magjike, por me personazhe dhe vende reale. Në thelb të këtyre katër romaneve, të shoqëruar edhe nga ilustrimet e Xu Mingzhen dhe Li Jing, është jeta e një vogëlusheje, e quajtur Jaja. Autorët e serisë “Librat e stinëve” Gao Chunxiang dhe Shao Min nëpërmjet personazhit kryesor rrëfejnë raportin e Jajës me gjyshin, me të atin e saj, me komunitetin, si dhe me natyrën, një fabulë e njohur dhe europeanisht, por këtë herë trajtuar ndryshe.

Librat e serisë, të titulluar jo rastësisht “Pranvera”, “Vera”, “Vjeshta” dhe “Dimri”, e njohin lexuesin me stinët e vitit, por që kinezët, sipas një kulture të lashtë, i ndanin në 24 faza diellore. Duke shfletuar këto libra, lexuesi ynë do të bëjë një udhëtim të paharrueshëm në festat folklorike tradicionale kineze, do të mësojë ritualet e vjetra, do të vëzhgojë kafshët dhe bimët, por më e rëndësishmja: do të dëgjojë gjuhën e natyrës. Përgjatë udhëtimit, Jaja, e cila qëndron një vit në një zonë rurale, tek shtëpia e gjyshërve në fshat, do të njihet me natyrën, kohë e kaluar aq shëndetshëm.

Nëpërmjet historisë së Jajës dhjetëvjeçare, lexuesi ynë i vogël kërkon të njohë natyrën në një dimension tjetër, si një shembull për t’u treguar prindërve, të cilët rroken që ta mësojnë fëmijën veç me teknologjinë gllabëruese, se sa shumë e bukur është natyra, sesa e shëndetshme është jeta e një fëmije në fshat, shpirtërisht dhe mendërisht.

Librat, pajisur edhe me ilustrime tërheqëse, i ndihmojnë të vegjlit dhe bëjnë kureshtarë të mëdhenjtë për ta shfletuar dhe shijuar së bashku.

Mbi disa qenësi të poezisë së Frederik Rreshpjes

# Imazhi poetik si qenësi e poezisë, e komunikimit dhe e ndikimit artistik

Nga Anton Nikë Berisha

*“Çka është një poezi lirike? Për sa më përket mua, nuk do të dija ta përcaktoja (definoja) këtë gjë të rrallë (feniks arab), këtë çudi, këtë objekt përcaktueshmërisht tejet konkret, ose të pandjeshëm për arsye se është i bërë nga fjalët, këtë bashkëjetesë të çuditshme të muzikës dhe të metafizikës, të arsyes e të paarsyes, të ëndrrës e të përgjimit!”.*

Euxhenio Montale

## Teksti përbërësi qenësor i krijesës poetike

Në ligjëratat rreth stilistikës të shkallës së tretë në Fakultetin filozofik të Universitetit të Zagrebit, prof. Krunoslav Pranjiq (Krunoslav Pranjić), ndodhte të na sillte një tekst të një poezie të një poeti të shquar të letërsisë së përbotshme (të përkthyer në kroatisht), pa emrin e autorit. Ne, studentët, në bazë të analizës të tekstit, duhej të përcaktonim se cilës periudhë (rrymë) letrare i përkiste teksti, pastaj cilës letërsi dhe së fundit dhe cili mund të ishte autori i tij. Në bazë të mënyrës së vështrimit të objektit poetik, të veçantive të gjuhës dhe të sistemit të të shprehurit, ndonjë nga studentët (natyrisht jo unë) edhe ia qëllonte. Ky veprim i prof. Pranjiqit kishte për qëllim të dëshmonte se vetë teksti letrar ishte përbërësi kryesor që përcaktonte qenësinë e krijesës poetike dhe se në bazë të tij mund të vëreheshin e të ndriqoheshin veçantitë e stilit e të vlerës poetike të veprës së një autori, pa ia ditur emrin dhe pa njohur diçka nga jeta e tij.

E përmend këtë fakt për arsye se në studimet tona letrare në shumicën e rasteve ndodh e kundërta: i kushtohet më tepër vëmendje autorit e jetës së tij se sa veprës – tekstit, duke e lidhur atë kryesisht me rëndësinë që mund të ketë pasur ose ka autori brenda një periudhe ose brenda një letërsie, rrethanat shoqërore, kulturore dhe politike që e kanë përcjellë hartimin dhe botimin e veprës e të ngjashme.

Ky “fat” e përcolli në përgjithësi dhe studimin e poezisë së Frederik Rreshpjes, pa asnjë dyshim njëri ndër autorët tanë bashkëkohorë më të shquar e më të veçantë. Pra, mëvetësia dhe vlera e poezive të tij u lidh me pësimet dhe me burgosjet që ai përfytyroi në sistemin komunist (nga mosha 14 vjeçare) dhe vuajtjet e shumta që i përfytyroi edhe pas këtij sistemi, duke mbetur i pathyeshëm përballë vështirësive të jetës.

Studiuesit e mëdhenj të letërsisë (midis tyre dhe studiuesi kroat, Zdenko Škreb), theksojnë se të dhënat jetësore të një shkrimtari mund të ndihmojnë që të vihet një komunikim më i mirëfilltë dhe më i gjerë me tekstin letrar poetik, po teksti poetik është përbërësi i gjithëpushtetshëm dhe i vetëmjaftueshëm për përcaktimin e veçantive, të mëvetësisë, të vlerës artistike të një veprë letrare dhe të komunikimit të saj.

Arsyeja pse duhet të nisemi nga teksti poetik kur i qasemi dhe komunikojmë, përkatesisht e interpretojmë poezinë e Frederik Rreshpjes është e qartë: teksti poetik i përfutur nga ai e përligj mëvetësinë dhe rëndësinë e tij si poet. Për këtë arsye është rrënuese të njëjtësohen jeta, vuajtjet dhe pësimet e këtij autori me tekstin e përfutur si fakt gjuhësor shprehës dhe vlerë poetike.

## Gjuha poetik, të shprehurit poetik – përcaktuese e vlerës së veprës letrare

Nëse nisemi nga mendimi i Xhon Miltonit për librat se ato “[...] në fakt, nuk janë aspak gjëra të vdekura, përkundrazi, përmbajnë në vetvete një fuqi jetësore, që i bën ato po aq aktivë sa vetë shpirti, pjellë e të cilit janë; për më tepër ata

1 E. Montale, *Sulla poesia*. Milano, Mondadori 1976, f. 171.

ruajnë, si në një ampulë, forcën dhe esencën më të kulluar të atij intelektit të gjallë që u dha jetë”, atëherë mund të thuhet se poezia e Frederik Rreshpjes nuk është asgjë tjetër pos fryt i shpirtit gjallëruar të poetit, që shpreh dukuritë më të fshehta dhe më të veçanta të botës së tij, në të njëjtën kohë shpreh, edhe botën e tjetrit, botën e njeriut.

Krijesa letrare poetike është e veçantë nga fakti se është fryt i botës së brendshme, i shpirtit të poetit; i përfytyrimit dhe i imagjinatës së tij që përligjet dhe komunikon përmes tekstit që përftohet. Me pak fjalë, vepra – teksti poetik i krijuar bën jetën e vet të pavarur, jashtë autorit dhe jetës së tij. Vepra letrare përftohet përmes gjuhës dhe se qëllimi kryesor i saj është të shkaktuarit e kënaqësisë – ndikimit artistik në marrësin. Të gjitha të tjerat janë të dorës së dytë. Pra, ajo që e ka kushtëzuar dhe e ka përcaktuar rrugëtimin e veprave letrare poetike nëpër kohë – jetën e tyre të gjatë – është arti i tyre, jo diçka tjetër, si, fjala vjen, tematika (Góngora duhet të jetë ndër të parët që tha se një libër i rëndësishëm mund të mos vijë nga një temë e rëndësishme). Mendimet e shprehura përmes gjuhës poetike nuk janë të rëndësishme si fakte dhe të dhëna ose gjetje konkrete për një dukuri, po, siç thekson Niçe, për shpërnderimin që ato mendime ose ato ide bëjnë tek ne<sup>3</sup>.

Qenësia e poezisë së Frederik Rreshpjes ndërlihet me atë që thoshte Lascelles Abercrombie për poezinë e Vvalt Vvhitman-in: “[...] ai nxori nga përvoja e tij e fisme atë figurë të gjallë dhe vetjake që është njëra nga të paktat të mëdha të letërsisë moderne: vetë figurën e tij”, mendim që mund të plotësohet dhe me atë të Sir Edmund Gosse-s: “S’ka Walt Witman të vërtetë... Witmani është letërsia në gjendjen e protoplazmës: një organizëm intelektual...”<sup>4</sup>.

Poezia që përftoi Frederik Rreshpja, sidomos pjesa më cilësore e saj e përfshirë në këtë zgjedhje, e përcakton atë në mënyrën më të mirëfilltë, përkatesisht është dëshmia më e mirë e qenësisë dhe e veçantisë së tij si poet dhe e pasurisë së tij shpirtërore krijuese.

Gjuha poetike që përdor Rreshpja, siç ndodh te çdo poet i madh, nuk është një fakt shkencor dhe si e tillë s’ka si qëllim t’i përcaktojë saktësisht gjërat, dukuritë, po përmes shumësisë së mendimeve që dalin nga struktura përkatese e tekstit letrar, të shqiptojë variantitet (motërzimet) e mendimeve dhe të ndikojë artistikisht në lexuesin. Këtë e ka shprehur bukur Edgar Allan Poe: “Kemi qenë veçanërisht ne Amerikanët që e kemi përkrahur këtë ide të lumtur e ne bostonianët, në mënyrë akoma dhe më të veçantë, që e kemi zhvilluar atë tërësisht. Kemi ngulitur në tru, se të shkruash një poezi thjesht për hir të poezisë e ta njohësh se ky ka qenë dhe qëllimi yt, do të thotë ta tregosh veten tërësisht të mangët nga forca dhe dinjiteti i vërtetë i poetit — por e vërteta e thjeshtë është se, nëse do t’ia lejonim vetes kundrimin në thellësi të shpirtit, atëherë do të zbulonim menjëherë që nuk ekziston e as që mund të ekzistojë në këtë botë ndonjë vepër më tërësisht dinjitoze — më sublimisht fisnike se ajo poezi e vërtetë — ajo poezi *per se* — ajo poezi që është veç poezi dhe asgjë më shumë — ajo poezi e shkruar vetëm e vetëm për hir të poezisë [...] Do të qe vërtet i verbër ai që nuk e përfytyron dot dallimin rrënjësor e parimor midis së vërtetës dhe aftësisë poetike

2 Xhon Milton, *Areopagjytika. Në fillim ishte fjala...* Shqipëroi Ajsela Koka. Botimet Dritan, Tiranë 2004, f. 71 – 72.

Duke folur për librin Xhon Miltoni thoshte: “Kush vret një njeri, vret një krijesë të arsyeshme, imazh të Zotit; po kush shkatërron një libër të mirë, vret vetë arsyen, vret imazhin e Zotit në vetë thelbin e tij”. Shih Xhon Milton, *Areopagjytika. Në fillim ishte fjala*, vep. e përm., f. 72.

3 Jorge Luis Borges, *Inkuizicionet e tjera*. Përktheu Astrit Cani. Botimet Ideart, Tiranë 2005, f. 86.

4 Jorge Luis Borges, *Inkuizicionet e tjera*, vep. e përm., f. 81.

të mendje-ngulitjes së një morali. Do të qe një teoricien i çmendur deri në pa përgjegjeje, ai që, pavarësisht nga këto dallime, do këmbëngulë ende të bashkëpërzije vajrat e ujërat kokëfortësisht të papërziershëm të poezisë dhe së vërtetës”.

Kur thellohem në sistemin gjuhësor shprehës, në mënyrën e përfutur të pamjeve (të tablove, të imazheve) poetike, që sa ndryshojnë po aq edhe afrohen me njëra – tjetrën, që dëshmojnë mirëfilli në këtë vëllim, atëherë nuk është vështirë që tekstin e një poezie ta përcaktojmë se është i Frederik Rreshpjes pa qenë shënuar emri i tij.

Përmes tekstit Rreshpja shpreh dhe shpalos botën e vet shpirtërore, të ndjeshme e të ashpër, fatlume ose tragjike. Ai është i vetëdijshëm se bota e brendshme e njeriut është një burim i pafund, i paskajshëm i veçantive dhe i fshehtësive, pikërisht ashtu siç thoshte Chesterton: “Njeriu e di se te shpirti i tij gjinden ngjyrat më tronditëse, më të panumërta dhe më të pathekshme se ngjyrat e një pylli vjeshtor...”<sup>5</sup>. Pra, poeti Rreshpja shpreh atë që ndien, që gjallëron brenda tij dhe bën përpjekje që gjithë ajo veçanti dhe pafundësi të thuhet sa më lartësisht përmes tekstit poetik. Kjo mënyrë e përfutur (strategji), ku çdo gjë lidhet me dukuritë shpirtërore, me botën dhe kohën subjektive, ku gjërat ndodhin ndryshe në krahasim me botën (jetën) konkrete, i jep poezisë së tij cilësinë e paanësisë dhe të përjetësisë, pikërisht ashtu si thoshte Jorge Luis Borges: “Nëse e ardhmja dhe e kaluara janë të pafundshme, nuk do të kemi realisht një kur”<sup>6</sup>. Me fjalë të tjera, pamjet poetike që i përfuton Rreshpja shprehin para së gjithash pamjet e shpirtit të tij të trazuar e të rebeluar, tundimet dhe tronditjet, herë - herë të pazakonshme.

## Përkim dhe njëjtësim i mendimit teorik me tekstin poetik

Frederik Rreshpja hyn në rrethin e ngushtë të poetëve tanë bashkëkohorë që, nga një anë, mendimi i tij për artin e fjalës, për poezinë dhe, nga ana tjetër, teksti poetik (poezia) që e krijon, përkohë e njëjtësohen në disa rrafshë e përbërës. Në mënyrë të veçantë teksti që ai e përftoi, e përcakton dhe e sqaron thellësisht parimin e tij poetik dhe gjakimin e tij si krijues.

Rreshpja qysh herët ishte dhënë pas poezisë (“Që fëmijë e kam kuptuar se kisha lindur / I mallkuar me art”) dhe ishte i vetëdijshëm se ajo ishte një punë dhe mision që kërkonte përkushtim të mirëfilltë dhe flijim të vijueshëm (“Poezinë e kam pasë për qejf shumë [...] që në poezi të bëjë diçka...”). Natyrisht, sa më shumë e pasuroi përvojën jetësore, sa më shumë që u ballafaqua me jetën dhe vështirësitë që dalin në veprimin e përditshëm, vizioni i tij prej poeti shkoi dhe u bë më i pasur dhe më i ngritur.

Mendimet e Rreshpjes për poezinë dhe natyrën e saj herë – herë nuk janë të njëjta, ndonjëherë edhe të kundërta, dukuri që nuk është e panjohur tek krijuesit, qoftë të letërsisë sonë, qoftë të letërsive të tjera (“*Pa emozione nuk mund të shkruaj. Poezinë e shkruaj në një gjendje të lartë emocionale*”, thotë në një intervistë<sup>8</sup>). Ndonjëherë, kur poeti flet për poezinë, përdor gjuhën poetike, prandaj mendimet nuk duhet të merren në kuptimin e parë (“Nuk me intereson poezia”). Rreshpja nuk flet në mënyrë të mirëfilltë për poezinë: ai e krijonte atë, jetonte me të dhe nuk fliste për të siç flet një studiues i letërsisë. Të fliste për poezinë domethënë të fliste për veten, për poetin, siç thuhet: të pëshytynte përpjetë dhe t’i binte në fytyrë. Ai parapëlqente të fliste për atë që ai nuk ishte, që nuk e zotëronte, për atë që ishte e panjohur, që duhej zbuluar; poezinë e kishte të veten, ishte njësuar me të, ishte vetë poezia (“Çdo gjë që kam, e mbart me vete” thoshte Ciceroni). Tekstet e poezive të tij flasin në mënyrë të mirëfilltë për atë që si e mendonte poezinë si art dhe qenësinë e saj si kumt (mesazh) dhe mundësi komunikimi, si pasurim shpirtëror dhe si ndikim estetik.

Brenda mendimit të tij dallohen sidomos dy çështje. E para ai dinte se çka shkruante “Megjithatë unë e di se çfarë shkruaj” dhe e dyta: me poezinë ishte i njësuar për një kohë të gjatë, qysh nga mosha e re.

Në procesin e ndërliqshëm të përfutur dhe të njësimin me poezinë, Rreshpja bëri përpjekje të vijueshme që të

5 Edgard Allan Poe, *Poezi dhe ese*. Përktheu nga origjinali Dritan Thomollari. Plejada, Tiranë 2004, f. 99.

6 Jorge Luis Borges, *Inkuizicionet e tjera*, vep. e përm., f. 121.

7 Jorge Luis Borges, *Inkuizicionet e tjera*, vep. e përm., f. 113.

8 Shprehur përmes një metaforë Gazmend Krasniqi thotë “Fredri ishte një njeri që nuk i interesonte poezia, por poezia ishte e interesuar për të” Shih Gazmend Krasniqi, Poeti i 100 lirikave. botuar në gazetën “Koja jonë”. Shih Monda - 30 Tetor 2009.

krijohet një stil të tij: “Kam mbi pesëdhjetë vjet që shkruaj poezi dhe synoj të shkruaj çdo ditë. Lufta ime qëndron në zgjerimin e fjalorit poetik dhe në përsosjen e stilit. Jashtë modesteve, tashmë unë mund të flas për një stil. Unë kam qenë një poet i vetëdijshëm e punëtor dhe kam braktisur çdo gjë për poezinë. Në punën time laboratorike, përiqem ta gjej poetikën në çdo objekt apo ngjarje”<sup>9</sup>.

Edhe një dukuri tjetër heq peshë në mendimin e Rreshpjes: poezia është krijimi mendjes dhe jo i zemrës. Me fjalë të tjera, poezia është krijesë që për ta hartuar kërkon mund e dije; frymëzimi është dukuri që e nxit krijimin, po nuk hyn në sistemin e përfutimit, të shtjellimit të tekstit e të gjuhës poetike që përdoret në të: “Sipas zbulimeve të fundit poezia qëndron në tru, jo në zemër, dhe lidhet me inteligjencën”, thoshte Rreshpja.

Rreshpja synon të jetë i kursyer kur e harton tekstin poetik; të përfshijë sa më shumë mendim me sa më pak material gjuhësor shprehës. Si kursimtar në fjalë synonte t'i përngjante Poradecit: “Më pëlqen të vazhdoj rrugën e Poradecit (është më i larti)”. Stili i mëvetësishëm nënkupton gjuhën poetike të mëvetësishme e të pasur. Poezia nuk mund të shkruhet me gjuhën e rëndomtë ose siç theksonte Rreshpja, me gjuhën që nuk përkon me natyrën e poezisë: “[...] ca libra të shkruar me gjuhë kuzhine”.

Lidhja dhe njësimi i Rreshpjes me poezinë s'ka qenë e njëjtë në rrjedhë të kohëve; në moshë të pjekur e ka përjetuar dhe e ka krijuar poezinë ndryshe në krahasim me kohën e fillimit: “Kam vënë re se tani poezinë e shkruaj më me pasion se kur kam qenë 20 vjeç”.

Rreshpja e thekson edhe një dukuri të rëndësishme: fshehtësinë (misterin) e nxitjes për hartimin e poezisë, siç do të thoshte poeti arbëresh, De Rada – provaninë hyjnore<sup>10</sup>: “Edhe ndjej një shtytje të brendshme, sikur më thotë engjëlli mbrojtës, ‘shkruaje këtë’. Se për mua personalisht, nuk do të merresha më me letërsinë”<sup>11</sup>.

Poeti Rreshpja thekson se kur shkruante poezi ishte i trishtuar; ky trishtim lidhej me vetminë, që e nxiste dhe e ushqente gjithë atë që krijonte. Krahas kënaqësisë shpirtërore poezia i shkakton edhe dhimbje. Sa më shumë që ai shkruante poezi, sa më shumë që njësohet me të, me aq më shumë e ndjen vetminë (“Shkrimtari ndjehet i vetmuar gjithmonë”), peshën dhe trishtimin e saj (“Unë kam qenë trishtimi i botës”). Së këndejmi: “Kur trishtëhem shkruaj, prandaj shkruaj shumë [...] Përgjithësisht kohën e kaloj në dhomën time, i vetmuar. Pastaj ‘sa me shumë të shkruash, aq me i vetmuar je’ thoshte Heminguej”<sup>12</sup>.

Mendimin e mirëfilltë dhe të qenësishëm të Frederik Rreshpjes për poezinë, siç u tha, e përligj vetë poezia, tekstet poetike që ai i hartoi, për çka do të bëhet fjalë në pjesët në vijim të Parathënies. Këtu po përmend vetëm një pjesë nga testamenti i tij, që ndërlidhet në mënyra të ndryshme me mendimet e sjella më lart. Kjo shprehet sidomos në metaforën “I mallkuar me art”:

*Që fëmijë e kam kuptuar se kisha lindur*

I mallkuar me art.

Gjërat i shihja ndryshe:

Nëpër shirat e vdekur

Peshqit fluturonin drejt çerdheve të yjeve.

Në vend të borës binin zogj në çdo dru.

Era si ketër brente degët.


Qante mbi mua nëna, Shënmëria ime. Ave nëna ime!

(Testament)

### Poezi e përfytyrimeve të pasura dhe të parëndomtë

Rreshpja përftoi një poezi burimore dhe të mëvetësishme, fryt i një bote të pasur shpirtërore dhe i një përfytyrimi të parëndomtë, që dëshmohej sidomos nga poezitë e përfshira në këtë zgjedhje – si pjesa më cilësore të poezisë që krijoi ai.

Rreshpja përmbys shumëçka nga rëndomësia e krijimit dhe realitetit konkret: përmbysat figuracioni, përmbysat metafora, krahasimi. Me një fjalë, ai krijon diçka që nuk ekziston në përditshmëri: “Përditë më duhet të nxitoj drejt diçkaje që nuk është”, thotë ai, po që bëhet e mundshme dhe konkrete në rrafshin poetik shprehës, që mundëson



ndërlidhjen me atë që ka mundur të jetë ose që mund të ndodhë, të ekzistojë qoftë dhe në mendje.

Kështu, teksti poetik që krijon Rreshpja, e zgjeron përfytyrimin për të pamundshmen, që bëhet e mundshme; në tekst gjërat bashkëjetojnë në mënyrat nga më të ndryshmet dhe brenda kohës subjektive: “Tërë shirat e botës i kërkova për ty” (Dal e të pres buzë një reje). Pra, poezia e tij është pjellë e imagjinatës, që ngrihet nga realiteti konkret, po që është e kundërta (kundërvënja) e atij realiteti. Ajo nuk është projektion i realitetit, siç ngjet, fjala vjen, në përrallë, po është edhe realizim i atij projektioni, bëhet vetë realitet komunikues dhe ndikues (si tekst).

Rreshpja “flet” përmes pamjeve, tablove (imazheve), që nxitën nga dukuri të ndryshme, po përmes strukturës gjuhësore shprehin e përfutjnë një botë të veçantë, për të mos thënë të jashtëzakonshme. Këto pamje shprehin qenësinë e tyre si tërësi, siç ndodh dhe me mozaikun dhe komunikimin që nxit ai, që asnjëherë nuk është i njëjtë. Pamjet poetike janë tërësi më vete; ato funksionojnë dhe ndikojnë në formën e poezisë, të vargjeve ose të një vargu. Brenda tyre bashkëjetojnë shprehje e figura të ndryshme, që s'kanë ndonjë funksion e vlerë si të veçura.

Në rrafshin e poezisë si pamje tërësore mund të sillen disa shembuj në këtë zgjedhje “Era përkund pikëllimin e luleve”, si grupe vargjet janë të thuash në çdo poezi, ndërsa si një varg, po ashtu mund të sillen disa, si fjala vjen, “Rrjedhin liqejt malorë nën erë” (Liqejt malorë); “Kur era e kaltër vë në gjumë valët” (Ode për detin), *U shuan yjet në pëllëmbët e mia* (Është një zog...)

Koncepti i përfutimit të poezisë së Rreshpjes ngrihet kryesisht mbi parimin e qenësisë së hijes, që nënkupton subjektin në një formë tjetër, të ndërmjetme, të shndërruar, po shumëfishë më të rëndësishëm dhe me mundësi të ndikimit më të madh. Pra, Rreshpja përfuton tablo jo për vetë ato, por për atë që ndodh ose mund të ndodhë nga hija e tyre, ajo që të vë në lëvizje, që nxit përsiatje dhe të vë në kërkim të zbulimit dhe të njohjes. Kjo ndërlidhet me një mendim të Anton Pashkut për artin e fjalës: krijuesi i mirëfilltë nuk shqipton vetë rraptimën (zhurmën), siç bëjnë shumica e poetëve tanë, po shkaktarin e rraptimës, jehonën e saj: “[...] nuk e tërhiqte (njeriun – v. ime) fort rrapëtimi që dëgjohej nga të gjithë, po ‘ajo’ që shkaktonte rrapëtimën. Kjo, me siguri, nuk ishte kurrfarë ikje nga realiteti objektiv”<sup>13</sup>.

Pra, Rreshpja e gjakon shkaktarin e rropamës e jo rropamën vetë, për këtë arsye poezia e tij të prapëson nëse kërkon njëjtësimin me realitetin konkret, me përditshmërinë. Këtu janë arsytet që poezia e tij është cilësuar e errët, e pakuptueshme, se komunikon vetëm me poetin! Kjo është një pandehmë që vetë poezia e tij e zhbën. Poezia që ngrihet e përbëhet nga gjuha poetike, nuk mund të kuptohet (po të kuptohet siç mendon dikush, atëherë teksti i saj duhet të ketë një kuptim); shumësia e mendimeve që dalin prej një teksti poetik shpesh është e pafund dhe receptohet në mënyra të ndryshme prej lexuesve të ndryshëm; madje edhe prej të njëjtit lexues në rrethana e kohë të ndryshme. Në vend që të flasim për të kuptuarit e poezisë së Rreshpjes, duhet të flasim për mundësitë dhe format e komunikimit të saj; për degëzimin e këtij komunikimi sidomos nga lexuesi

me përvojë, nga lexuesi që kërkon shumë më tepër prej një teksti sesa një mendim dhe kumt të rëndomtë. Teksti poetik shërben – duhet të shërbejë vetëm si nismë e përsiatjeve dhe e përfytyrimeve që mund e duhet të nxitë tek marrësi. Këtu qëndron qenësia e komunikimit dhe të ndikimit të secilës krijesë të artit të fjalës.

Poezia e Rreshpjes është poezi e vetmisë shpirtërore, që i kundërvihet edhe vetë vetmisë si dukuri; është poezi e shqetësimit, e dhembjes. Këtë e dëshmojnë dhe fjalët kryesore që përdor: vetmia, dhembja, nata, mjegulla, shiu, hëna, lotët, deti, vjeshta, gjethet, vdekja, Itaka, etj. Rreshpja vështron edhe dukuri të së kaluarës, figura të shquara historike (Skënderbeu, Fishta), qytetin e lindjes, Shkodrën e ndonjë tjetër.

Krijesat e tij poetike si shtjellime gjuhësore shprehin vizione që shumëfishohen në procesin e perceptimit dhe të ndikimit dhe si modernitet dëshmon vijimësinë e traditës së poezisë sonë moderne (De Rada, Poradeci, Camaj). Mirëpo, pafundësia dhe burimësia e përfytyrimeve të Rreshpjes i kanë bërë të mundur Rreshpjes që të shkojë një rrugë tjetër, ta pasurojë dhe ta lartësojë dukshëm poezinë moderne shqiptare me përbërës të veçantë.

Bota poetike e Rreshpjes s'është botë ëndrrash, nuk është botë e fantazisë, që ka qëllim fantazinë vetë, po botë e përfytyrimeve shqetësuese e tronditëse; e tundimeve dhe e pësimeve herë – herë të skajshme shpirtërore, që përligjen nga teksti i shtjelluar me përkushtim e dije; është vetja e poetit: vetë figurën e tij<sup>14</sup>.

Njëmendësia konkrete, dhuna dhe pësimeve e vijueshme, ia zunë frymën poetit Rreshpja, ia prishën drejtpeshimin e veprimit e të menduarit dhe ai përmes poezisë iu kundërvë gjithë kësaj; përmes artit të fjalës kërkoi dhe e krijoi një realitet të lirë, një realitet artistik si katarsë shpirtërore me të cilin, edhe ngushëllohet, edhe mund të vihet komunikim dhe të ndikohet prej tij. Atë që i mungon poetit në jetën e përditshme, e krijon, si mbijetim, përmes përfytyrimit dhe tablove poetike. Përmes poezisë, vetja e poetit shprehet si një lloj prototipi.

Pamjet poetike që i përfuton Frederik Rreshpja s'kanë qëllim sqarues ose udhëzues, ato përfutohen si një mundësi ekzistimi dhe komunikimi, siç ndodh me ikonat ose me mozaikët në muret e kishave, ku hyjnorja bëhet e zakonshme, ose e zakonshmja shndërrohet në të pazakonshmen, në hyjnore, jo për vetë pazakonshmërinë e saj (si pazakonshmëri), po për t'u afruar e njësuar, për ta njohur dhe zbuluar më thellësisht (të zakonshmen) ose për t'u shmagur asaj. Është e ditur se në çdo shmangje dhe kundërvënje të realitetit (siç ndodh që në çdo të mirë ka një të keqe edhe në çdo të keqe ka një të mirë) nuk shpëputet lidhja me të dhe gjurmët e saj shfaqet në formën e amëzimit, të arketipit.

Poezia e Rreshpjes gjakon sa shpalimin e të fshehtës, të panjohurës ose të mundshmes, aq dhe shndërrimin në të. Arti modern, brenda tij dhe poezia, e ka thyer parimin se mund të ndikohet në njeriun për të mirë vetëm përmes shembullit të mirë, ndonjëherë mund të ndikohet dhe më shumë përmes një forme tjetër, një shembulli të kundërt, të keq ose të shëmtuar.

(Vijon në numrin tjetër)

9 Nga biseda e Shpëtim Kelmendit me Frederik Rreshpjen.

10 Poeti arbëresh e thotë këtë në mënyrë të qartë në *Parathënien*, që i vë librit të parë të *Skanderbeut të pajan* (1872) dhe që e riboton te *Një pasqyrë e shtegtimt njerëzor* - 1897: “Dhe Poezia është një privilegj si dhe Profecia, nuk bëhet (nuk prodhohet) sipas vullnetit të njeriut. Vizioni i veprimit hyjnor për ndryshimin e fateve të njerëzve është një dhunti e Profetëve, përgatitja për jetën e lartësive u përket vetëm Poetëve të lindur”. Shih Girolamo De Rada, *Poesie albanesi Voll. II. Uno Specchio d'umano transito*. Napoli, 1898, f. 6.

11 Bisedë e F. Rreshpjes dhënë gazetës “Sot”, 1 nëntor 2005.

12 Bisedë me Frederik Rreshpjen, Zëri Rinisë, 25 Nëntor 1992.

13 Anton Pashku, *Mbi komunikimin poetik*. Në “Jeta e re”, Revistë letrare, n° 4 (Kushtuar Anton Pashkut), Prishtinë 1996, f. 610.

14 Shih Jorge Luis Borges, *Inkuizicionet e tjera*, vep. e përm., f. 81.

# KISHA E SHËN SOFISË

nga I. Kadare

murale

I

Vezi­rët po zgjo­heshin njëri pas tjetrit. Meqenëse asnjëherë nuk ishin gdhirë aq pranë (shatorrja e ministrit të Luftës ishte pothuaj ngjitur me atë të ministrit të Punëve të Jashtme, dhe kjo e fundit dy hapa larg nga shatorrja e vezirit të madh, çka e bënte edhe më të rrokshëm shkallëzimin), pritej që, si në çdo shtet të përsosur, ata të ngriheshin nga gjumi sipas shkallës hierarkike. Mirëpo ishte mëngjesi i 30 majit, kaltërsia e qiellit ishte marramendëse, veç kësaj, shumica e tyre ishin të bindur se, bashkë me Kon­stan­di­no­polin, krishterimi i gjithë ishte rrëzuar, kështu që lajmi se veziri i madh ishte zgjuar ndërkaq, e ata ishin ende në shtrat, nuk iu duk kaq i fundjetshëm. Disa, ashtu siç pritej, kishin brofur në këmbë, por kishte pasur të tjerë, që edhe pa qenë të plagosur, ishin kthyer në krahun tjetër, për të përfutur edhe një grimë gjumth, madje flitej se drejtori i Pallatit të Ëndrrave i ishte përgjigjur thirrjes lajmëruese të fqinjit të tij, ministrit të Thesarit, me fjalët: “mos më çaj kryet”.

Vetëm kur u mor vesh se vetë sulltani ishte zgjuar, gjithçka u lëkund si në një tërmet. Ata ngriheshin rresht, me sy të fryrë, me qeska të zeza poshtë tyre, shkëputeshin mundimshëm nga vargorët e gjumit, donin të shpëlanin gjakun që iu duk se i kishte përlyer përsëri në ëndrra, të befusuar shihnin njëri-tjetrin, thua se habiteshin dhe vetë se si kishin mundur të dilnin nga ato guva, thoshin: ç’ishte ky gjumë plumb, o Zot, disa përligjeshin duke u kujtuar që kishin dy muaj pa mbyllur sy, përmendnin thënieën “gjumi është vëlla i vdekjes” e të tjerët thoshin: desh vdiqem vërtet, të sigurt se kishin qenë me fat që e kishin kaluar këtë provë të fundit.

Qielli ndriste ngazëllueshëm dhe ata, që një ditë më parë s’e kishin pasur për gjë të rrezikonin jetën te muret e sketerrshme, befus druheshin se mos gërriceshin tani te kulmari i shatorres, i shmangeshin një grethi, qeshnin edhe vetë me këtë kujdes të tepruar, gjersa në vetëdijen e tyre mbërrinte i plotë e i ndritshëm mendimi se ishin gdhirë në një kohë të re, vërtet të re, ku jeta çmohej një mijë herë më fort.

Që larg, nga kryeqyteti i pushtuar vinte zallahia e ushtarëve, që ishin ndërkaq në orën e tridhjetë të plaçkitjes e të orgjisë.

Edhe dyzet e dy orë, tha me vete arkitekti Kauri. Ishte i shtrirë në shtratin e fortë, as i fjetur, as i zgjuar. Ca pamje, me të cilat fare lehtë mund të ndërtohej një ëndërr dhe po aq lehtë të rrëzohej, i rinin në sy. Përpiquej të merrte me mend se cilat ngrehina ishin rroposur ndërkaq dhe ç’do të shkatërrohej ende në dyzet e dy orët që iu mbeteshin ushtarëve nga afati triditësh, gjatë të cilit qytetin do ta kishin në mëshirën e tyre. Kishin pritur më tepër, si ata, si komandantët, në mos një javë, së paku, pesë ditë, por urdhri kishte dalë drejt e nga shatorrja e sulltanit: tri ditë, sipas traditës, asnjë orë më shumë.

Jashtë u dëgjuan thundrat e një kali që u ndal vësh-tirshëm, pastaj zhurma e njeriut që u hodh përdhë dhe, së fundi, zëri i tij: Tenda e arkitekt Kauri? E kërkon sulltani, në çast!

Roja e arkitektit u shfaq me fytyrë të llahtaritur.

- Arhond, arkitekt efendi, sovrani të kërkon.

- E dëgjova, - u përgjigj arkitekti dhe u ngrit. U vesh me ngut, hodhi krahëve zhgunin e bardhë me shenjën e arkitektit të ushtrisë në qafore dhe u nis.

Që larg e kuptoi pak a shumë se përse e thërritnin. Drejt sheshit të madh, përpara shatorres mbretërore, po rendnin, të ndjekur nga rojat e tyre, dinjitarët dhe komandantët e lartë. Kur mbërriti, e mori vesh saktësisht: do të bëhej hyrja ngadhënjyese në Kon­stan­di­no­pol.

Me lëvizje të kokës ai iu përgjigj përhëndetjeve të gjithkahshme. Ngazëllim i tillë s’ishte parë ndonjëherë në asnjë kremtim. Dukej si një gdhirje në parajsë pas një tmerri.

Sulltani doli, më në fund, nga shatorrja e tij. Diçka i thoshte vezirit të madh duke treguar tej pamjen. Ishte, me sa duket, ai vetë dhe jo kipci i tij.

Vargani i gjatë, pasi kapërceu ngushticën, zbriti nga anijet e u rreshtua prapë në bregun tjetër, ku prisnin kuajt. Që larg, kulmorja e kishës së Shën Sofisë ndriste në diell. Kryqi ishte ende sipër saj. Fytyrat e dinjitarëve ishin të shqetësuara: do të hynte vallë sulltani në ngrehinën që mbante shenjën e mallkuar?

Arkitekti nuk i ndiente më këmbët. Ëndrra për t’u futur në kishën më të madhe të botës i ishte dukur aq e pamundur, sa dhe pavdekësia. Shpejt, thoshte me vete, shpejt. I dukej se nga çasti në çast, përpara se ata të mbërrinin, kisha do të shembje ose do të shkimej larg.

Kreu i varganit kishte arritur ndërkaq te hyrja. Njerëzit ngriheshin mbi shalët e kuajve, për të parë ç’ndodhte te porta. Dëgjoheshin fjalët “po hyjnë, po hyjnë”. Vezi­rët po zbrisnin nga kuajt, disa kthenin kryet pas të lemeritur, si të bëheshin gati të iknin me vrap. Porta e kishës po gëlltiste dalëngadalë gjithçka. Falmë, o Perëndi, tha arkitekti, kur kapërceu pragun.

Kryet dhe trupi iu thithën befus nga lart. Një dritësim i pabesueshëm, me një gazavaj midis, vinte që nga kulmorja. Arkitektit iu duk se po zbërthehej. Muskujt e trupit, dejtë lidhës, kyçet po i bëheshin fir me ngut. Ishte befus në qendër të gjithësisë. S’e kishte menduar kurrë se drita e burgosur midis mureve të një ngrehine të ishte më e dendur dhe më e pamatë se ajo e lira, e jashtëmja. Ai dritësim ishte i tillë që e treste njeriun dhe ashtu të shtrupëzuar, si në një ethe qiellore, e hidhte në shtjellat e pafundësisë.

Arkitekti e ndjeu se të gjithë ishin nën goditje. Sytë iu ishin zbardhur, ndihej që ishin duke mposhtur natën brenda vetvetes, dhe terrin dhe kaosin, dhe se kjo ishte më e mundimshme se çdo krusmë.

Ai hetonte fytyrën e sulltanit për të kuptuar ç’vendim do të merrte. Korat e arta rrëzëllinin vajtimthi. Fytyrat e Krishtit e të nënës së tij, madje, dy perandorët e pikturuar të rënë në gjunjë përpara tyre, ishin të gjithë të pikëlluar. Ndihej ende era e qirinje dhe e temjanit të meshës së fundit, mbajtur një ditë më parë.

Sulltani ngriti prapë kryet drejt dritës së padurueshme, që vinte nga kulmorja. Arkitekt Kauri i mori me mend fjalët e tij: Të shembet kjo dritë e paturpshme. Të zhbëhet! Qysh tani.

II

Sikur ta kishte dëgjuar pëshpërimën e sulltanit te veshi i vezirit të madh, një turmë e mbledhur ndërkaq përjashta, me fytyra të trembura, e shpërndau atë gjithandej: kisha, me sa dukej, do të shembej.

Pa dalë ende perandori nga ndërtesa, kasnecët, të rrëmbyeshëm si era me shi, ngarendën kudo për të çuar urdhrin.

Te pragu, arkitekti ktheu edhe një herë kryet. Një çast iu duk se rrënuesve nuk do t’u durohej sa të dilnin dinjitarët e fundit për ta rroposur ngrehinën. Mendimi se ndoshta do të duhej të kthehej brenda e të shihte si do të rrëzohej ai dritësim qiellor, i erdhi ftohtësisht. Mendoi se më parë mund ta bënte, po tani kishte ikur tepër larg.

Përjashta, drita e ditës, e rëndomtë, e zvetënuar, si një rrobë e larë mijëra herë, rrinte mbi qytet. Që larg vinin zhurma, trokitje portash dhe klithma grash. Ai falënderoi Zotin që i kishte dhënë mundësi të shihte ndërtesën më të bukur të botës, përpara se të binte.

Iu duk se dëgjoji shungullimën e parë të rrënojës dhe mbylli sytë. Por ishte një kalorës që u shemb përmbri tij, si të binte nga lart. E kërkonte sulltani, këtë herë përnjëmend, jo bashkë me të tjerët, por vetëm.

Kur ai hyri, ata e prenë të folurën. Ishte hera e parë që e shihte nga afër sulltan Mehmetin. Deshi t’i thoshte: së paku, për shembjen e saj mos më cakto mua, imzot. Por s’fliste dot.

Mehmeti i Dytë ia kishte ngulur sytë me njëfarë habie, në skajin e së cilës kishte një nënqeshje.

- Kam dëgjuar për ty, - tha pa e vështruar.

Nënqeshja ishte e përzier me kureshti, madje, me një hije frike dhe arkitekti deshi prapë t’i thoshte: mund të gjeje tjetër kënd për këtë.

- Të gjithë presin që unë të jap urdhër për shembjen e Shën Sofisë, - tha sulltani. - Topat janë gati ndërkaq. Rrënuesit me vegla në duar, gjithashtu. Dhe fuçitë me vajguri, dhe vozat me sqfur. Dhe ti arkitekt, mbase je bërë gati. - Sytë e ngushtë të sulltanit ishin ngulur jo mbi fytyrën e arkitektit, por diku më poshtë, ndoshta te mesi i trupit të tij. - Kështu pra, ju të gjithë jeni bërë gati...

Unë jo, tha me vete arkitekti. Kam Zotin dëshmitar.

Sulltani buzëqeshi, më në fund, vërtet.

- Kurse unë do t’ju zhgënjej, - tha me zë të ulët. - Unë do të bëj tjetër gjë. Madje, të kundërtën e asaj që doni ju.

Arkitekti nuk po iu besonte veshëve. Sulltani thoshte se sapo kishte dhënë urdhër që të ndërpritej plaçkitja dhe orgjitë e ushtarëve, ndonëse ishte ende mesi i afatit triditësh, se turqit nuk ishin si grekët që i mbytnin e i bënë rrafsh qytetet e pushtuara, se Kon­stan­di­no­polin do ta bënte kryeqytetin e perandorisë së tij dhe se Shën Sofinë, që thoshin se ishte qendër e botës, jo vetëm nuk do ta shembte, por do ta bënte edhe më të bukur.

Arkitekti nuk gazmohej dot. Ndiende ftohtë në gjymtyrë dhe më ftohtë në shpirt. Si mund të bëhej më e bukur Shën Sofia, o Perëndi, thoshte së brendshmi.

- Ty të kam zgjedhur për këtë, - tha sulltani.

Ai tregoi me dorë trupin e arkitektit, thua se mund të dyshohej se arkitekti mund të ishte dhe tjetërkund.

Përse, deshi të pyeste Kauri. Përse më ke zgjedhur, imzot?

- Siç thashë, as do ta shemb, as do ta djeg Shën Sofinë, - vazhdoi mbreti. - Siç thashë, do ta bëj më të bukur.

- Jo.

Ishte vonë që atë “jo” ta gëlltiste prapë. Kishte dalë, ndërkaq, dhe të gjithë kthyen kryet gjithandej, thua se fjala e shkurtër vërtitej si zog i plagosur përreth.

- S’bëhet më e bukur Shën Sofia, madhëri, - tha arkitekti.

Sulltani nënqeshi. Ishte i vetmi që e thërriste “madhëri” dhe “imzot”, sipas mënyrës së kaurëve. Por kjo atij i pëlqente.

- Bëhet, Kaur, - tha ai. - Unë Shën Sofinë do ta kthej nga kishë në xhami. Dhe ti që guxove të thuash “jo”, ti pikërisht do ta bësh.

Të tjerët pritën që arkitekti të binte në gjunjë, të kërkonte ndjesë për “jo”-në e parë, të thoshte një “jo” të dytë, përpara se të vdiste, të përgjërohej për besimin që po i jepnin, të thoshte: vramë, po këtë s’e bëj dot, të kërkonte afat, para, vdekje. Por ai s’bëri asnjë nga këto, veç qëndroi i ngurosuar në vend, i bardhë në fytyrë.

- Ty të kam zgjedhur për këtë, sepse ti je më i zoti dhe... më i përshtatshmi, - tha sulltani. - Ti je i vetmi që je në mes... as i krishterë, as mysliman... madje kam dëgjuar se je një midisës... as burrë, as grua... - Arkitekti ishte më i bardhë se gëlqerja. Sytë e perandorit ishin ngulur prapë te qendra e trupit të tjetrit. - Deledashët te ne i mbajnë për të shenjët, - vazhdoi, me po atë zë të lodhur. - Nday ty po të besoj qëndrën e botës.

Këto ishin fjalët e fundit, pas të cilave ai nuk priti përgjigje. Ktheu krahët dhe doli i ndjekur nga rojat.



## III

Ditë me radhë ai vërtitej rrotull kishës. Ata që e ndiqnin me sy nga kureshtja, spiunët që e përgjonin, për të njoftuar pastaj çdo lëvizje të tij, të dërguarit e fshehtë të sulltanit nuk kuptonin asgjë. Nuk kishte hyrë brenda asnjëherë, veç sillej përçark, thua se merrej jo me vetë ngrehinën, por me hijen e saj. Kështu edhe ishte shkruar në kumtimet: “duket sikur sheston hijen e kishës”.

Në të vërtetë, atë hetonte, hijen. Mendonte se më mirë se prej gjithçkaje tjetër, një ndërtesë kuptohej nga hija e vet. Në të ndihej, më qartë se kudo, edhe pesha, edhe ankthi i saj.

Dy herë tek përendeji, i ra sëmundja e tokës. Njëra nga rojat e tij, që ishte edhe mjek, ndërsa ia mbante kryet që të mos i dëmtohej, i bënte me shenjë tjetrit të shënonte vendin e rrëzimit, meqë mendonte se mund t'i duhej më pas.

Ai vetë i ndiente shikimet që e përcillnin me kureshtje, dashakeqësi apo mosbesim. Përveç atyre që mezi ç'prisnin që tempulli të ndërronte shpirt, ishin ata që luteshin që më mirë të rroposej se të kthehej në xhami, e të tjerë që s'dinin ç'të bënin, të gëzoheshin që s'u shemb apo të brengoseshin për përdhosjen.

Një nga përgjuesit e dërguar enkas prej sulltanit tha se, sipas mendimit të tij, arkitekti, me atë endje si prej të përhijituri, s'bënte gjë tjetër veç rrënonde dhe ndërtonde diçka brenda vetes, me fjalë të tjera, përgatitej për atë që do të bënte.

Atë ditë që do të hynte në kishë, bëri një banjë të gjatë. Me sytë nga qielli, sikur trupin e tij lakuriq po e sillte si dëshmi përpara Zotit, u lut një kohë të gjatë. Por në lutjen e tij kishte edhe përhirim, edhe pezmi, edhe kërcënim të verbër. Mëshiomë, i tha Zotit, por fjalët i nxirrte njëllor sikur të thoshte: mos më ndërhy.

Në pasqyrën e argjendit ishte trupi i tij i zbehtë, gati i tejdukshëm, me një ngjyrë midis së bardhës e së dyljtës, krejt si midis qiellit dhe tokës, dhe me dejtë e kaltër, nëpër të cilët gati-gati dallohej gjaku që rendte nga veriu në jug e nga lindja në perëndim.

Deledash, përsëriti me vete fjalët e sulltanit, pa i hequr sytë nga seksi i tij, një lloj sythi i sapobuthtuar, si i ndalur në mëdyshje midis trajtës mashkullore e femërore, me puhizën e pangjyrtë të leshnajës sipër tij. S'kishte lindur më kot më 23 shtator, ditës që në shumë vende i thoshin *sanatadita*. Një midisës, kujtoi prapë fjalët e sovranit, me shikimin e ngulur te mesi i trupit të tij. Një dykaks ose, më mirë, askahs.

Ai u lut përsëri dhe prapë lutja kishte brenda egërsi dhe shkrim. Puhiza sipër seksit dukej se nga çasti në çast do të valëzohej e do të nxuhej.

Përpara se të vishej e përfytyroi hyrjen e tij në kishë dhe dritësimin që vinte nga lart, me të cilin shpresonte të merrej vesh. Tretmë, i tha atij dritësimi, si t'i drejtohej një fisnaku të vet.

Deshi të qante, po, për habinë e vet, qeshi. Kishte një liri që s'i duhej dhe që s'kishte frikë ta humbte. E dinte që, po ta humbte, do të ishte edhe më i lirë, por as kjo s'i duhej.

S'i duhej, pa dyshim. Veç në qoftë se... në ditën e largët... të martesës së tij me... vetveten.

## IV

Ata që në krye habiteshin nga sheshi i ndërtimit rrotull kishës e mblidhnin veten shpejt, madje dhe e qortonin. Natyrisht që ky shesh s'kishte si të ngjante me asnjë tjetër, përdërisa këtu kryhej një gjë vërtet e paparë, diçka që s'ishte as ndërtim e as shkatërrim, ose që ishte përzjerje e të dyve, ose jashtë të dyve, ose midis.

S'ngjante me kurrfarë ngrehine në ngritje ose në prishje. S'ishte as kështjellë, as mur, as piramidë, as mashtrim në formë pingu lëvizës. Ose, pa qenë asnjëra, ishte gërshetimi i të gjithave bashkë me një tërmet të ndodhur nëntëqind vjet më parë, përvoja e të cilit u shërbente, sipas rastit, të dy kaheve. Më fort do të mendoje se ishte muri që po e ndërtonin së bashku kinezët dhe barbarët, ose kështjellë e përbashkët e mësymësve dhe e mbrojtësve, ose kali i drunjët (ky i fundit, për shkak të qytetit të saporënë dhe fjalimeve të fundit të sulltanit, ishte bërë temë e ditës), që s'dihej kujt do t'u shërbente: grekëve kundër Trojës apo Trojës, më pas, kundër grekëve.

Arkitekti vështronte mendueshëm gropat e gëlqeres, qereçin, grumbujt e gurëve, rërën, qerret që venin e vinin me kërkëllimë. E kishte rrethuar nga të gjitha anët dhe ashtu, ngadalshëm, si nëpër gjumë do ta shtinte në dorë tinëzish. Hyjnitë i kishin dhënë, më në fund, mundësinë të kryente atë që ishte në harmoni me natyrën e tij. Do të rrënohej e

do të ndërtohej ai vetë prej saj. S'do të dihej kurrë cili ishte i fituari e cili i munduri, ashtu siç nuk e kishte kuptuar kurrë se cila prej të dyja fillesave do të ngadhënjente në trupin e tij: mashkullorja apo femërorja.

Ishte, pa dyshim, ngrehina e vetme në botë që vihej përpara provës së ndërrimit. S'besonte se do t'ia shkulte përnjëmend krishterimin, më shumë shpresonte ta kthente në shtëpinë e parë, ku do të rrinin nën të njëjtin pullaz dy fetë e mëdha të botës.

Hetonte ngjyrën e gëlqeres që herë rrëzëllente nga një dritë e brendshme e herë murrëtohej gjithë trishtim. Ishte vështirë, pa dyshim. Ishte njëllor si të mendoje dy shpirta strehuar në të njëjtin trup.

Herë-herë, sidomos në prag të rënies së sëmundjes së tokës, në atë grimë kohe gjithë çarje dhe dritë, i dukej se hynte në lidhje me tërmetet që e kishin dëmtuar, për të marrë vesh diçka më shumë. Por çasti përpara goditjes ishte i shkurtër, kurse trallisja pas tij e linte të vvarë për një kohë të gjatë.

Ngjyrat me të cilat do të mbuloheshin fytyrat e Krishtit e të Shën Mërisë ishin aty, në vedra të mëdha, të përgatitura tashmë, në pritje. Por ai nuk ngutej. E kishte nisur ndërrimin me katër fraza të Kuranit, që po vizatohehin në katër kënde përballë njëri-tjetrit. Vendin ku do të lartësohej minareja e kishte gjetur, gjithashtu. Dhe tremen e lutjes së sulltanit. Më vështirë ishte theksimi i drejtimit të Mekës dhe zbehja e



atij të Jerusalemit, që binte në sy qysh në vështrimin e parë.

Çdo fundjavë sulltani kërkonte një njoftim të veçantë për punën. Ditën kur sollën gjysmëhënën prej bronzi, që do të zëvendësonte kryqin mbi kulmore, erdhi veziri i madh. Ndërsa litarët e vargorët e ngjtinin gjysmëhënën lart, nëpër po atë humnerë përmes së cilës ishte zbritur kryqi, të gjithë ngrinë në pritje. Po nuk ndodhi asgjë. Rrezet e diellit ndriçonin shkujdesshëm bujtësen e re, që i ishte afruar pa drojë qiellit. Përkundra, ishte hëna ajo që, kur doli, e përndriti fare ftohtë shemrën e saj.

## V

Lëndimthi ata kalonin furçat me gëlqere mbi fytyrën e Krishtit e të nënës së tij. Por gëlqerja ishte aq e hollë, saqë pas tharjes, rishfaqeshin, në krye, kurora me gjemba, që dukej se e griste e para pengesën, pastaj plagët e kryqëzimit e pas tyre gjithçka.

Mjeshtrit vinin për t'i kumtuar me pyetjen e heshtur në sy: a do ta trashte, më në fund, gëlqeren? Arkitekti bënte të kundërtën: e hollonte edhe më, si të donte ta ngjasonte me qiellin.

Tani Krishti dhe Shën Mëria dukeshin si prapa një hukatjeje në qelq. Spicëtarët, ndërkaq, kishin arritur të çonin letrat gjer te sulltani. Kur e lajmëruan të paraqitej, e dinte

ç'do të ndodhte. Klithmat “kaur!”, “tradhtar”, “bukëshkalë”, i dëgjoji mospërfillës, si të thuheshin përpara një kufome. Ndryshimi i vetëm ishte se ndodhej në këmbë.

Kur i erdhi radha të shpjegohet, foli shkurt dhe qartë. Mënyra si po e mbulonte ai pamjen, që duhej mbuluar, ishte e vetmja. Përndryshe, shpirtësia e krishterë, e ndryrë krejtësisht pas gëlqeres, do të ishte më e fuqishme. Ajo ishte atje, ai e ndiente brenda çdo guri, madje më thellë. S'duhej mbytur vrazhdësisht, kurrsesi. Vetëm ashtu, gjysmë e lirë, siç e linte ai, do të dobësohej natyrshëm.


Si përherë, doli ngadhënjës. Por, kur u kthye në kishë s'kishte asnjë gëzim. Një kohë të gjatë hetoi gëlqeren në vedra. Ishte aq e mjegullt, saqë ia pasqyronte, ndonëse zbehtë, fytyrën. Një kohë të gjatë u mahnit pas asaj pamjeje. I ngjante një maske. Kështu ndoshta pamja e pandryshueshme e njeriut skajohej diku në librin e botës.

Si përherë, i ra një copë herë kryq e tërthor kishës. Një pjesë e shtyllave ishin me dy fé, ndërkaq. Ana e majtë e kulmores, gjithashtu. Trembëdhjetë prej dyzet dritareve, lëkundeshin. Kisha tërhiqej ngadalë. Dukej sikur lëshonte pe, por mu midis sprapsjes mësynte befasisht. Ai bënte të njëjtën gjë. Ia duronte trillet, madje s'mund ta mendonte ndryshe veç ashtu: trillane. Nganjëherë jepej pas hamendjeve për të ardhmen e saj. Ç'do t'i bënte vallë kjo frymë e re që po i futej: do ta plakte papritur, do ta rinonte, apo do ta bënte të pavdekshme? Shumica, ashtu siç pritej, e kishin

kuptuar këtë ndërrim si ngadhënjim të islamizmit. Një pjesë, më e vogël, përkundrazi, si qëndresë të krishterimit. Kurse disa të paktë kishin kapur në të një kumt të ri: kapërcimin e të pamundurës. Ishin të tmerruar nga kjo zbulesë, kishin rendur nëpër shtëpira, kishin mbuluar kryet me thes, për të mos menduar më, pastaj, kur kishin parë se kështu mendohej më rrezikshëm, i kishin mbajtur sytë hapur me ditë të tëra, madje, kishin prerë flokët gjer në rrëzë, nga frika se mos grimca të dyshimeve kishin mbetur në to. Së fundi, e kishin kuptuar se e gjithë kjo ishte e kotë dhe asgjë s'mund t'i shkulte as dyshimin, as pyetjen nëse të dyja fetë e mbyllura në të njëjtin burg do të jetonin të dyja apo do të vdisnin të dyja.

Era e thatë, që nisi të frynte nga stepat, e shtonte trazimin. Nganjëherë midis kuisjes së saj dukej sikur ndihej ulërima e ujkut të hirtë turk, shenjë e vjetër e osmanëve, por askush nuk e kuptonte dot se ç'kishte në atë ankim të zgjatur.

Arkitekti vejevinte midis altarit dhe vendit të lutjes së perandorit. Nën shakullinën e erës, shtyllat ngjanin edhe më të heshtura. E treta, e katërta, e shtata, shtylla që djersitë, ajo që thoshin se ia hiqte dhembjen e kryes perandorit kur mbështeste ballin në të, e dymbëdhjeta, me një të fshehtë në pjesën e sipërme të saj, e katërmëdhjeta, ku besohej se ishte strehuar pendimi i një zonje të lartë, pastaj tjetra, dhe tjetra përbri, dhe e fundit gjithë pezmi.



Ka kohë, thoshte me vete, ndërsa ecte me hapa përherë e më të shpeshtë. Kishte kohë, pa dyshim, për të kuptuar më mirë, për t'i shembur ose për të rënë në gjuhë përpara tyre.

## VI

Lutja e parë islamike u bë të premtën. Sulltani u ul i vetëm në vendin e vet. Të tjerët zunë vend rresht në tremen rrotullore. Imami e lexoi Kuranin me shpatë zhveshur, çka do të thoshte se tempulli i fituar me gjak, po me gjak do të mbrohej.

Sulltani nuk e ngriti asnjëherë kryet nga kulmora, për të mos dhënë asnjë shenjë se po mendonte shembjen.

Thirrja "Allahu është i madh", e dalë nga qindra mushkëri, rikumboi një copë herë, gjersa ra e ftohur gjithkrah.

Pas lutjes, sulltani mbeti i fundit, me një pjesë të vezirëve dhe rojat. Nuk dha asnjë shenjë se i dhembte kryet, veç kur iu afrua shtyllës së famshme djersitëse, e mbështeti ballin në të.

Njerëzit e shpurës nuk dinin ç'të bënin: të shtireshin sikur s'kishte ndodhur asgjë, të habiteshin apo të thërrisnin kryemjekun.

Koha rridhte ngadalë dhe vështrimi i vezirit të madh ishte gjithë shqetësim. Mpirja i kishte ngurosur rojat. Sulltani me sytë gjysmë të mbyllur dukej se do të flinte. Vetëm njëri sup i tij, i djathtë, lëvizti dy herë rresht si nga një ngërç. Pastaj, me një lëvizje të beftë, jo vetëm balli, po krejt trupi iu shkëput prej shtyllës, si t'i shmangej një goditjeje. Dora e djathtë, e mbërthyer te milli i thikës, iu duk të gjithëve e verdhë. Të tjerët kujtuan se lëshuan një "ah", që s'e dëgjoji megjithatë askush. Sulltani diçka murmuriti nëpër dhembë, por thikën nuk e nxori. Madje, e shqiti dorën prej millit dhe e çoi te balli.

Në kohën që kryemjeku po vinte me vrap, sulltani i ktheu shpinën shtyllës dhe, pa vështruar kurrkënd, eci drejt daljes.

Arkitekt Kauri mbeti, më në fund, vetëm. Në veshë kishte ende fundin e një murmurime, që shpura e kishte lënë pas, si fëshfërimën e gjatë të një rrobe. Shtylla... deshi ta... godiste... mbetiste... mbretin...

Ai iu afrua shtyllës, një grimë hetoi një njollë të lehtë lagështire, pastaj i mbylli sytë. Kur i hapi, kishte shpresë se diçka do të shfaqej në spikamën e zbehtë të njollës. Por ajo ishte njëllë si më parë, pakëz më e thellë ndoshta, me një shkëputje midis. Ai iu afrua edhe më, e mbështeti ballin dhe priti. Shtylla ishte e ftohtë. Megjithatë, një si rrahje e lehtë që, me sa dukej, i përgjigjej rrahjes së ballit të tij, ndihej përherë e më qartë. Folë, tha me vete arkitekti, duke e ngjeshur krejt trupin pas saj. Më jep një shenjë, nëse mundesh.

## VII

Nuk është e vërtetë se desha ta godisja sulltanin. Gjithçka ishte pjellë e trurit të tij. Qysh se e mbështeti ballin tek unë, e ndjeva në çast ngjashmërinë me të tjerët. E njoh mirë këtë racë mbretërisht. Gjatë nëntëqind vjetëve që jam këtu, me dhjetëra perandorë të Bizantit kanë mbështetur ballin mu ashtu si mbreti turk, duke kujtuar se çliroheshin nga dhembja e kokës. Në të vërtetë, më shumë se

nga kokëdhimbja lehtësoheshin nga të tjerat. I kam njohur mirë ankthet e tyre. Si dridhmat kalonin nëpër trupin tim dyshimet e para, pas të cilave vinin të dytat, dy herë më të zeza, e kështu me radhë: meritë, që ata vetë i merrnin për dashuri, filizi fillestar i kriminit, tmerrri i zbrazëtisë dhe vetëtima e braktisës së vjeshtës së vonë, e parë në ëndërr bashkë me brilantet e krimbura të kurorës.

Ata iknin nga unë të lehtësuar, por herën tjetër kur vinin, dejtë mend iu çaheshin nga gufmimi i helmit. Dhe kapeshin pas meje përherë e më fort, si i mbytur pas litarit, duke shpresuar të pamundurën.

T'i them të gjitha këto jo se m'i kërkove, jo se më the: më jep një shenjë në mundsh (oh, ata të gjithë më janë lutur kështu), por sepse ti je ndryshe... Qysh se e mbështete qendrën e trupit tënd pas meje dhe unë ta ndjeva atë heshtje tempulli, e kuptova se ti je ndryshe nga ata. Ti je si unë.

Qindra vjet nuk jam marrë vesh dot me ta, pikërisht ngaqë kërkoni nga unë të pamundurën. Vinin të mbështesnin ballin, me fytyrë të ngrysur, kinse të vuajtur, kurse, në të vërtetë, mezi ç'prisnin sa të ngjeshnin trupin. Pas mëndafshit të qëndisur me ar, ua ndieja seksin të ndehur po aq pamëshirshëm si thikat e tyre. Kurse e çara e grave ishte edhe më e humneshme. Ndërsa burrat kërkoni të më depërtonin, ato donin të kundërtën: të përdhunoheshin prej meje. E mbështetnin seksin më egërsisht se burrat dhe prisnin ethshëm, çmendurisht. Sepse asnjëra prej të dyja palëve nuk e merrte dot me mend se unë nuk isha ashtu siç shpresonin ata, por ndryshe.

Unë jam si ty, i ëmbli im, ndaj dhe po merremi vesh bashkë. Gjithë historinë e këtij shteti mijëvjeçar që u përmbys dje, e kam këtu, në poret e mia. Si çmërs vetëtimash, mendimet e tyre, duke vrjuar poshtë e përpjetë meje, kanë lënë gjurmë kudo. Dhe pak më parë, kur truri i sulltanit lëshoi rrëkezën e parë të mendimit, ai e ndjeu se ajo u ndesh me mbeturinat e tyre. Sepse ata janë të së njëjtës racë, i ëmbli im. Pavarësisht se ç'shenja mbajnë mbi petkat e tyre dhe ç'hyjnive iu falen.

Unë i di të gjitha, madje e di se pikërisht për këtë jam bërë e rrezikshme. Unë e njoh qysh më parë thikën që do të përgjaket. Dhe te druri pranveror që ju i dalloni veç gjethet, unë kap arkëmortin e fshehur, që do të bëhet prej dërrasave që do të dalin prej tij... Kaq herë më është dukur se s'do të jem në gjendje ta përballoj këtë ngarkesë të fshehtë dhe një ditë do të plas. Ata e dinë këtë, ndaj shpesh kanë menduar të më heqin qafet.

Ti mund të mendosh se unë jam një shtyllë e marrë. Sidoqoftë, ti nuk do të jesh aq i egër sa ata, i ëmbli im. Shumë-shumë ti do të kërkosh që një pjesë të trupit tim të ma lidhin me fashë të hekurt, ashtu siç iu vënë të çmendurve këmbësorë e forcës. Ndërkaq, ti do të jesh aq fisnik, sa të mos e shpallësh çmendurinë time. Do të thuash vetëm se nga droja që kjo shtyllë e vjetër të mos plasë, është bërë ky meremetim. Dhe turistët, duke u vërtitur rreth meje do ta besojnë këtë dhe ndoshta, për herë të parë në jetën time nëntëqindvjeçare, unë do të provoj keqardhjen e të tjerëve... Ti po qan, ndërkaq?

Tiranë, prill 1994

## Vrasja e T. Ivan Ivanoviçit

tregim nga

### ANDRIN KABASHI

Albert Smithi ishte një djalë i ri i cili studioje për Apikturë dhe trajtën artistike të saj në Akademinë e Arteve të Bukura. Jetonte në një bujtinë aty pranë Akademisë, duke qenë se vinte nga një qytet tjetër, qytet në të cilin nuk gjeje ndonjë perspektivë të lartë zhvillimore artistike.

Ajo çka binte në sy tek ai, ishte fiziku i tij. Flokët i kishte bojëkafë me kaçurrela. Zakonisht i mbante të lidhur pas koke, duke nxjerrë në pah sytë të cilët kishin një nuancë të veçantë blu, që shndrisnin në fytyrën e bardhë me pika poshtë syve. Shtati i tij nuk ishte ende i zhvilluar plotësisht. Ishte i dobët e i lig nga shëndeti. Ishte i dobët e i gjatë nga trupi. Gjithmonë ishte i bardhë, e kishte nga anemia.

Albert Smithi kishte zakon të kafshonte buzën e sipërme, madje shpesh ta lagte atë me gjuhë. E kishte zakon paksa të çuditshëm, por, mbi të gjitha, kjo e "çuditshmja" e tij e qetësonte kur ishte puna te ndonjë situatë stresuese me peshë të madhe, siç ishte ballafaqimi me profesorin e tij, Paul Casperin.

Atë ditë Alberti po qëndronte i ulur në zyrën e profesor Casperit, gjersa ky i fundit vështronte me kujdes punimin e fundit të Albertit. Tymoste një cigare e cila kundërmonte një erë tmerrësisht të keqe. Doemos që duhet ta ketë blerë tek tregu i gjërave të lira, aty shitet duhani më i keq në qytet. Sakaq, me të mbushur gojën plot tym cigareje, ai shtoi duke shfryrë plot tym:

- Ngjyra e gjakut të Ivan Ivanoviçit është e tmerrshme, Albert! - duke hedhur tutje punimin e studentit të tij.

- Por, profesor, - shtoi Alberti me zë të trishtë, - kjo është hera e tretë që po ma refuzoni pikturën time.

- Po, hera e tretë dhe nuk do të ketë herë tjetër për të



Unë jam Andrin Kabashi, jam një shtatëmbëdhjetë vjeçar nga Prishtina që deri më sot, kam të botuara katër drama. Jam anëtar në Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës (LShK), ku dallohem për moshën dhe shkrimet që kam.

(Nga letra për redaksinë e ExLibris)

të refuzuar! - u shpreh i mllëfosur profesor Pauli, gjersa fiku cigaren e tij në pikturën e Albertit.

- Por...

- Nuk ka "por", Albert!

Alberti ndërkohë iu gjunjëzua duke e mbërthyer nga dora tekta i lutej që të mos e ngelte. T'i jepte edhe një mundësi tjetër, të ndreqte gabimin e tij në kopjen e pikturës së famshme "Ivani i tmerrshëm dhe i biri Ivan".

Ai ishte një djall i vërtetë në formulimin e gënjeshtreve dhe fjalëve që të preknin në zemër. Artikulonte aq mirë fjalët, saqë bindte personin tjetër të bënte çka t'i kishte ëndja e tij djallëzore.

Edhe këtë herë, pa dalë huq, Alberti arriti të bindte profesor Paulin që t'i jepte edhe një mundësi të fundit. Ai i premtoi se do të punonte me sa forcë të kishte, madje, po qe nevoja, edhe më shumë se aq.

Në fund të bisedës, profesor Pauli ktheu kokën mënjanë dhe lëkundti dorën për t'i thënë Albertit se tashmë ishte i lirë të largohej. Sakaq, ai doli nga Akademia dhe mori rrugën për në bujtinë.

Bujtina ku banonte Alberti ishte e vogël dhe e ngushtë. Në të hyrë të saj qëndronin disa shkallë të cilat përthyeshin për të të dërguar në katin e dytë dhe pranë tyre ishte një korridor i vogël që të jepte rrugë për te një derë, për të cilën Alberti nuk kishte dijeni se ç'kishte pas saj. Pranë derës ishin disa shkallë të tjera, të cilat të shpinin për në qilar. Hyrja për në qilar ishte paksa e çuditshme. Kishte dy lloje formash për të hyrë. E para ishte rruga nga shkallët e cila përdorej gjithmonë, ndërsa e dyta ishte vetëm për depozitim e drurëve të dimrit, të cilët hynin në qilar nga një derë e veçantë, paksa e pjerrët dhe me dy kapakë që zëvendësonin derën.

Në qendër të këtij korridori të ngushtë gjendej një llambë e vetme që ndriçonte korridorin dhe shkallët gjer në kat të dytë. Dukej se llamba ishte vjetërsuar dhe duhej ndërruar nga dita në ditë, por askush nuk merrej me të. Kjo gjë Albertit i kishte rënë në sy, por, fundja, ai vetëm se banonte me qira në atë bujtinë dhe nuk i interesonte ajo llambë aspak.

Me të hyrë, Albert Smithi ngjiti shkallët për në kat të dytë, drejt apartamentit të tij jo fort të madh. Hapi derën, hodhi rrobat mënjanë dhe vuri përparësen e tij të pikturimit, duke iu futur punës pa humbur kohë.

\*

Atë ditë ishte e enjte dhe Albert Smithi kishte kohë deri të hënën të mbaronte pikturën e tij e ta dërgonte atë në Akademinë e Arteve, si punimin kryesor të vitit. Nuk dinte nga t'ia mbante. Tashmë kishte provuar të gjitha ngjyrat e mundshme që gjente në treg për të perfeksionuar pikturën në fjalë, por përsëri nuk arrinte dot të krijonte një ngjyrë të vërtetë gjaku.

Kishin kaluar dy ditë e gjysmë dhe Albert Smithi tashmë kishte përfunduar thuasë të gjithë pikturën, me përjashtim të vendit se ku ai do të vendoste ngjyrën e kuqe. Asnjë ngjyrë nuk përputhej! E vetmja gjë që ai bënte, ishte të kapte kokën e tij dhe të endej nëpër dhomë duke menduar se si vallë do të arrinte të kalonte vitin me këtë drejt pikturë që nuk po mundte ta mbaronte kurrë. Netët e vona e përcillnin atë nën ethe e djersë të ftohta që i kaplonin ballin, nganjëherë edhe duart, nga ku, furça i rrëshqiste e binte në tokë.

Në apartamentin e tij nuk kishte tjetër dritë të ndezur pos dritës e cila qëndronte pingul mbi pëlhurë, madje edhe dritaret ishin të mbuluara me perde, pasi Albert Smithi pretendonte se drita e përqendruar vetëm në pëlhurë do ta ndihmonte të shihte më qartë çdo pjesë të saj dhe të mos lejonte asnjë gabim t'i ikte nga sytë të cilët tashmë kishin zënë rrathë të zinj poshtë tyre.

Në një çast ai la furçën dhe ngjyrat. U ul në dyshe me një pjesë të errët të dhomës dhe mbështeti kokën mbi pëllëmbë. Tundej sa para-mbrapa, thua se po tundte veten që ky makth t'i kalonte sa më parë. Dhëmbët e tij kërcisnin nga presioni që ai ushtronte ndaj tyre. Ishte një zhurmë që të irritonte veshët. Pos të tjerash, filloi të shkulte flokët e tij, me qëllim që të ndiente një dhimbje tjetër, në vend të kësaj që e kishte



kapluar, duke menduar se do të dilte faqebardhë nga kjo katrahurë ku kishte hyrë. Në këtë situatë ai dukej i shkatërruar. Flokët e tij ishin të shturur dhe kaotikë, duke prezantuar më së miri gjendjen e tij. Frymëmarrja e tij gjithmonë e më tepër vinte duke u shpejtuar e duke u rënduar. Vrimat e hundës hapeshin e mbylleshin me të shpejtë për të thithur e për të nxjerrë sa më shpejt ajër nga mushkëritë e tij, të cilat kohën e fundit nuk kishin qenë edhe aq mirë.

Edhe pse duart i dridheshin, ai vazhdonte të grimconte thonjtë e tij gjithmonë e më tepër, duke i copëtuar ata me dhëmbë, të cilët, si për çudi, ishin krejtësisht të drejtë, pos dy prej tyre, pranë cepave të buzëve, të cilët ishin të gjatë e me majë. Ndonëse i shkujdesur e nën mendime, vazhdonte të copëtonte thonjtë, derisa dhimbja u dha kah tjetër mendimeve.

Pa se nga gishti po i dilte gjak!

"Kjo është ngjyra e duhur!" - mendoi me vete Albert Smithi me plot entuziazëm, pasi tashmë kishte gjetur një ngjyrë për përfundimin e pikturës së vdekjes së Ivan Ivanoviçit. Duart i dridheshin nga emocioni, ndërsa goja i kishte mbetur e hapur dhe i pikonte jargë jashtë dijenisë së tij, i cili qe i mahnitur me ngjyrën e ndezur të gjakut që qe shfaqur para syve të tij. U ngrit në këmbë dhe me dorë të dridhur, vendosi gishtin e gjakosur në pëlhurë, duke ngjyrosur fytyrën e Ivan Ivanoviçit me gjak të vërtetë. Ngjante hyjnore! Ishte kaq e vërtetë! Dukej tamam sikur para syve të tu të kishte tablonë e vdekjes së Ivanoviçit në krahët e të atit. Por ajo ngjyrë nuk mjaftonte! Pëlhura ishte shumë e madhe dhe vetëm një vrimë e vogël nga e cila rridhte pak gjak nuk mund ta mbushte me ngjyrë të tërë tablonë e pikturës ruse.

Pasi Albert Smithi pa se vetëm gjaku i vërtetë mund ta nxirrte nga situata ku qe katandisur, ai bëri zap të marrë thikën më të mprehtë që kishte e të priste damarët, që të posedonte mjaftueshëm ngjyrë për tablonë e tij. Kishte vendosur dorën e tij mbi një pjatë dhe mbi dorë thikën.

Zemra i rrihte fort! Duart vetëm i dridheshin nga frika dhe thika i lëvizte nga dora për shkak të djersëve që kishte, ndërsa ai mendohej ta mbante e ta kishte nën kontroll. Nuk kishte zgjidhje tjetër, duhet ta bënte me doemos! Provoi të rëndonte thikën, por ishte e dhimbshme. Filloi ta tërhiqte atë, por ishte edhe më e dhimbshme. Sakaq, një zë nga jashtë thërriti: "Posta!" dhe ai u ndal! Ngriti kokën dhe u afrua te dritarja. Largo i perden dhe u shtang kur pa se qe bërë mëngjes. Kishin kaluar sa e sa orë në errësirën që kishte krijuar, pa i vënë re tiktaket e orës. Në heshtjen vetjake të dhomës ku ai qëndronte shtrëngoi thikën në dorë dhe u nis drejt derës e cila gjithnjë e më shumë trokiste. Albert Smithi hapi derën dhe me sy të zgurdulluar i nguli thikën në qafë postierit, duke e lënë të vdekur. Nxitoi të merrte pjatën e ta vendoste sa më parë poshtë qafës së postierit, që të merrte gjak të pastër e të nxehtë

për pikturën e tij. Zemra sa s'i dilte nga vendi nga ajo se ç'kishte bërë! Fytyrën e kishte të dërrmuar, hundët vetëm i hapeshin e i mbylleshin me shpejtësi të madhe dhe nuk dinte çka të bënte tjetër, pos marrjes së gjakut që i nevojitej, gjersa gjoksi i tij dukej se do t'i dilte nga vendi nga frika dhe tronditja që e kishte kapluar.

Nga kufoma që gjendej para derës së tij mbushi plot dy pjata me gjak të pastër. Gjithmonë e më shumë dridhej në vete duke kafshuar thonjtë dhe duke menduar se ç'të bënte me kufomën e postierit. Për fatin e tij të mirë, ato ditë qe i vetëm në tërë bujtinën dhe asnjë nga pronarët apo banorët e tjerë nuk gjendeshin aty. Nuk kishte ide tjetër veçse ta linte në qilarin e druve, por do të duhej ta dërgonte deri poshtë. Megjithatë, nuk kishte zgjidhje tjetër. Albert Smithi e kapi kufomën dhe filloi ta tërhiqte zvarrë nëpër shkallët e korridorit të ngushtë të asaj bujtine të vjetër. Qafa e postierit gjithmonë e më tepër lëshonte gjak. Të gjitha shkallët ishin lyer me gjak të pastër e të nxehtë të një të pafajshmi. Me të arritur te dyert e pjerrëta të qilarit, poshtë, në fund të shkallëve kryesore, Albert Smithi i hapi ato, por problemi ishte se si ta ngjiste kufomën deri aty lart sa ta fuste në qilarin e druve. Në mendje i vajti që ta shpinte nga dera e qilarit, por më pas u kujtua se vetëm e zonja e bujtinës i kishte çelësat dhe askush nga klientët nuk mund të futej nga ajo derë. Ishte e kotë! Çdo tentativë e tij ishte e kotë. Ai mendohej me mish e shpirt ta merrte në krah të pafajshmin postier, por nuk ia dilte mbanë. Albert Smithi ishte një djallë i dobët nga shëndeti e nga shtati; nuk mund ta ngjiste lart një kufomë e ta hidhte në qilarin e druve thua se s'ka ndodhur asgjë. Pranë dyerve të pjerrëta të qilarit të druve gjithmonë qëndronte një sëpatë drush. E vetmja mënyrë që ai ta vendoste kufomën e postierit në qilar, ishte ta copëtonte atë e t'i hidhte brenda copat e trupit. Albert Smithi mori sëpatën dhe filloi të gjymtonte trupin e postierit të pafat. E gjymtoi dhe e hodhi në qilar, për t'iu kthyer punës sa më parë. Ishte e diel dhe piktura duhej të ishte gati për nesër.

\*

Profesor Paul Casperi ishte i kënaqur tashmë me pikturën dhe vijën artistike që Albert Smithi kishte përdorur në ngjyrimin e gjakut të Ivan Ivanoviçit. Piktura e tij u vendos në hollin e Galerisë së Arteve nën titullin e ekspozitës "Punime studentore".

Tri ditë më vonë, kur profesor Casperi po ndiqte lajmet e mbrëmjes në apartamentin e tij, në to u dha një lajm tronditës: "Një djallë i ri u gjend i vdekur në një bujtinë të qytetit. Hetuesia policore jep të dhëna se kemi të bëjmë me një vetëvrasje të dyshimtë, së cilës nuk i dihet shkaku. Policia dhe i gjithë ekipi i hetuesisë u shprehin ngushëllime familjarëve të viktimës!"

# Gruaja me ombrellë të verdhë *cikël poetik nga* **ROLAND GJOZA**

## NË RAFTE JANË LIBRAT

në rafte janë librat ngjeshur e shtypur te njëri -tjetri prej ngushticës  
asnjëherë nuk ua krijova komoditetin që duhej, ndonëse një pjesë janë nobelistë dhe të tjerët klasikë me art absolut për këtë vuaj, se shoh shekspirin si shtyp me shpatulla të fuqishme prej herkuli turgenievin fin dhe mopasani heq e vuan prej ushtarit të mirë shvejk kërkon ndihmë ivan bunini nga brutaliteti i vrazhdtë prej muzhiku të kont Tolstoit që shkruante romane aq të mëdha, të cilët shiten me një dollar te strand dhe shumë xhentëllmenë të tjerë që më kanë mësuar të shkruaj shiten me peni s'kam para të ngrej një infermieri që t'iu mjekojë plagët dhe dielli i zverdh dhe hëna si requiem iu jep ngjyrën e meitëve dhe një sallon bukurie sikur të ngre, kapakët t'ua bëj të bukur, fletëve t'iu jap një krehje të re rri dhe vështrij librat më të mirë që më kanë mbetur dhe dëshpërohem për ata që janë sakrifikuar me një pendim galileu sa shumë kam hequr për vend, për raftet që s'nxinin as modianon dhe më vjen të ngrej një stacion policie për çehovin që dy herë ma kanë vjedhur ç'them! më mirë t'i dorëzoh në bibliotekën e lagjes për brezat e ardhshëm të pensionistëve po fara e lexuesve mund të shuhet krejt dhe librat mund të jenë bërë ajër kibernetik jam gati të heq dorë nga librat dhe në raftet e zbrazur të vë servisin prej kristali që trashëgova nga babai me 99 pjata të thella, 99 pjata të cekëta, katër pjatanca, dy supjera, 99 lugë, 99 piruj, 99 thika të gjitha të lyera me platin një ditë do të përdoren për mortin tim.

## GRUAJA ME OMBRELLË TË VERDHË

në lagjen time në forest hills kinezë të vjetër nga tajvani dhe hong kongu ka jetojne këtu që kur u shkëputën nga kina po ata trupa të imët të hollë si shkopinj që vërtiten në ca shtëpi borgjeze me hieroglifë është dhe një cupkëz prej peneli që ngjyhet në vesë e hollë e gjatë po kaq hamgjitëse sa do t'ia propozoja klod monesë kur të hidhte irisët blu në ujë të mos harronte mbi urë të kalonte ajo me një ombrellë të verdhë konfuci prandaj ishte kaq i urtë me këtë vajzë sigurisht është takuar

dhe i është lidhur gjuha prej saj është zbutur nga dashnor i prapë është kthyer në at predikues dhe unë e prisha i thashë se ishte kaq e bukur sa isha gati të këmbëja kombësine time me murin e madh kinez natyrisht s'më kuptoi dhe qeshi i lashë takim u gajas si një majmunkë me atë turizh të lezetshme s'jam vajzë jam e martuar kam dy fëmijë në kolegji ajo vesë? s'tregojnë femrat kineze bjeri murit me kokë i thashë vetes prej bukurisë dhe konfuci u bë moralist klod mone s'pikturoi femra mbi urë prej kinezkës si vesë eh, ç'vete! në forest hills ndodhi kjo fajin e kanë tajvani dhe hong kongu që u ndanë nga kina të rrinin atje ku ishin te muri i madh do të shëtiste tani me ombrellë të verdhë dhe s'do të bënte me zemër një poet të lajthitur u pa puna edhe sikur vetëm ta shoh është gjë e madhe veç i lutem të më qeshë me atë turizh të lezetshme

## BLANA NËN SY

blana nën sy, duart t'u holluan, të dolën damarët blu në të gjelbër s'më vjen më të puth atë lëkurë të rreshkur se je pa vëmendje kështu të bëri jeta që kaluam e ke prej lodhjes, e dashur të humbi dhe ajo ndjeshmëri e freskët ajo intuitë e hollë për të përkthyer heshtjen themi kaq shumë fjalë për dashurinë po s'na shkojnë



të dua në gojën tonë me dhëmbë të vënë lind si një foshnjë e vdekur e mjerë të kujtosh rininë në kohën e barnave në mes të një përqaftimi për gëzimet e fëmijëve të dëgjosh zërin e mjekut për analizat që s'na kanë dalë mirë dhe ne e fshehim s'u tregojmë fëmijëve të vërtetën se dhe ata janë bërë të pavëmendshëm përditë ndiejmë ndarjen tonë ti e lidhur me ta fort e më fort, e padurueshme në manierat e tua unë larguar ikur dhe prej brinjëve të mia ikur dhe prej brinjëve të hijes që m'u shkurtua i vetëdijshëm eci drejt një fundi të heshtur më janë bërë drurët me ndjenjë dhe ku shkel me sentiment të hollë foletë me zogj kumi i oqeanit ku kaloj në perendim të diellit me fytyrë nga ujërat guaskat e hapura si trupa të braktisur prej shpirtave

## NATËS DUA T'I HAPEM

natës dua t'i hapem natës për vilarët e jargavanëve gurkali që varen në kangjelat e oborreve për ujërat e cekëta që formohen nga vesa në rrafshinën me bar të gjatë për zogjtë që flenë me sqepat e fshehur në pupla dhe për cergën e merimangës ku hija ime është kapur ashtu në terr i shoh të gjitha dhe s'i shoh tamam si hija që lëshon era mbi ujë ajo m'u shfaq dhe një herë për këtë natës dua t'i hapem dhe t'i lutem për një puthje në gjumë të më tregojë si të hyj në ëndërr dhe pa e zgjuar buzët t'ia vë mbi buzë ajo m'u shfaq dhe një herë prej ëndrrës dhe më bëri të lumtur natë, falemnderit! dita s'ma var ditën ajo bën dashuri me një tjetër natë, kam frikë se zgjohet dhe thërret e trembur vjen policia dhe më vë hekurat është në ëndërr, prej ëndrrës vjen shfrytëzo rastin, poet! prandaj e dua natën asaj i hapem për çdo gjë dashuritë më të mëdha dhe poezitë më të bukura natën i kam bërë dita është për milionerët nata për të varfërit dhe poetët

## KUR TI SËMURESH UNË BËHEM SI I ÇMENDUR

kur ti sëmuresh unë bëhem si i çmendur atëherë të dashuroj edhe më shumë shndërrohem në një fetar të bindur jam gati të ngarkoj mbi shpinë njëmijë ikona t'i lutem shën mërisë së virgjër më gjunjë jezu krishtit t'i pergjerohem me lot në sy besoj dhe te drurët po të më thonë se ata janë shpirta të shenjtë dhe jam gati ikonat t'i thyej në qoftë se nuk bëjnë gjë për ty respektoj si i krisur oraret e ilaçeve si atëherë kur te vija në takim dhe mjeku mjekërosh që më çmend; nuk po ia gjejmë dot shkaku më duket si një xhelat

unë dua dashuri dhe nga kasapi  
vuaj dhe jam gati të ngarkoj si kalë  
temperaturën tënde të lartë  
dhe prej një fluturë pres një shenjë  
dhe prej një zogut në dritare  
dhe prej diellit kur më hedh flori në dysheme  
dhe prej hënës kur më bën krejt blu  
se dritë nuk ndez  
që ti të mos shqetësohesh në gjumë  
supersticioz, mistik, bestyt  
le të më quajnë  
madje dhe të rrjedhur  
s'dua t'ia dijë ç'mendojnë për mua  
jepjani nobelin, po të doni  
dhe një idioti  
mjafton që ty të zbrisë temperatura

### DETI

deti vjen gjer lart te sytë e tu  
pastaj zbrer poshtë te gjinjtë me një kafshim prej shkume  
pastaj shkon poshtë e më poshtë dhe bën vizatime surreale  
prej uji  
në mes të kofshëve  
që hapen si gërrshërë dhe presin detin përgjysmë  
duke lënë një shteg të ngushtë për hënën  
ah, deti, deti  
i mallkuari  
që të merr  
dhe unë pres natën që do të fshehë në sjetullën me flatër  
era e njelmët, parfumet e forta, zhaurima e valës në kum  
klithmat e shpendëve që s'duken dhe që dalngadalë shuhen  
sirenat e anijeve larg dhe hëna që përsëritet në të gjitha  
dallgët  
dhe lind miliona të tjera me gaz të shfrenuar  
dhe qepallat e tua që mbyllen dhe unë që mbetem vetëm  
qepallat e tua që bëhen blu, fare blu  
dhe deti dhe deti që humbet brenda  
rreh vala e suvala në mishin tënd të freskët  
ia dëgjoj tingëllimen prej argjendi  
tani po të merr organet  
të parën zembrën duke vënë komandë dhe mbi ëndrrat  
ah, unë i mjeri që s'të mbroj dot as në gjumë  
tani i bëj roje agsholit dhe pres të zbardhë dita  
nga qepallat e tua të dalë deti  
deti i mallkuar

### RRIMË SHTRIRË

rrimë shtrirë dhe nga bulevardi poshtë dritares vjen zhurma  
e makinave  
te majë e gishtit tënd të madh qëndron hëna  
sikur do ta tërheqë këmbën në qiell  
të shkelë mbi vesën që bie  
njëri thumb i gjirit është në gojën time  
të dy lakuriq të ngjyer me mbrëmje  
përpiqemi të vëme në gjumë heshtjen  
do zemra e dehur nga poezia  
po s'do mishi  
gijotina e revolucionit francez ngrihet përsëri  
i pritët koka mbrëmjes  
siç e kemi zënë  
do t'i pritët koka dhe agimit

### RA VAN GOGU

eh, nëna ime  
e mira nëna ime e bekuar  
kur erdhi në Amerikë  
pa më pyetur mua  
hoqi nga dhoma e pritjes van gogun  
korbat në arën me grurë  
(ç'është kjo gjë e shpifur, landush?!)  
dhe vuri portretin e babait të vdekur në mur.  
ne s'pipëtimë,  
ne s'u ndjemë,  
megjithëse van gogu kishte rënë.

# Gruaja e ëndërrt

*tregim nga*

## ISTREF HAXHILLARI

Natë për natë shihte të njëjtën ëndërr si film me seri:

“Një grua shtatgjatë, me qerpikë të dendur, flokë të gështenjta mbledhur topuz pas zverkut, e vështronte në heshtje pa thënë asnjë fjalë. Thellë syve të errët në formën e bajameve të pjekura digjej një flakë e përhershme bojë alle.”

Zgjohej dhe ajo zhdukej për t'u shfaqur rishtas natën tjetër.

Pastaj tjetër...

Pamja e ëndërrt i mbushte natën.

Atë ditë doli pa çadër, hyri në dyqanin e parë që i zunë sytë të mbrohej nga shiu. Nxori shaminë, u fshi, ngriti kokën. Një femër e gjatë, shumë e bukur, me flokë lidhur pas shpine, pantallona të ngushta dhe bluzë gjysmë golf që ia gufonte gjinjtë, kishte mbështetur duart mbi tastierën e kompjuterit, kontrollonte shifrat në ekran.

Ai ngriu, sado u përpoq, e pamundur t'i largonte sytë.

Të nesërmen në të njëjtën orë, tani kohë me diell, hyri gjithë ankth ta shihte. Njëllor si ditën e parë, gruaja rrëzëlluese ishte përqendruar mbi ekran, nuk ia pa dot sytë. Ditën tjetër ngriti kokën, e përshëndeti, iu kthye kompjuterit. Po ata sy të kulluar e të mëdhenj me ngjyrë të papërcaktuar, i njëjti vështrim i qashtë e i pafajshëm, të njëjtat buzë që e torturonin natën!

Si të kishte dalë prej ëndërrës.

I mrekulluar nga bukuria e saj, çdo ditë pret në ethe orën të shkojë në dyqan, ta shtjerë ndër sy. Sa shkel atje, ajo ngre kokën, i dhuron atë buzëqeshjen e pa të dytë që sa vjen bëhet më joshëse, më premtuese, pastaj ngulet mbi ekran. Çfarë bën me atë kompjuter xhanëm! Thua nuk e kupton pse vjen aty, nuk e sheh se as ble ndonjë prej artikujve të dyqanit?

Sa i marrë?

Turret rrugëve të qytetit, hapësirave të blerta pranverore, ditëve të bardha të dimrit dhe kudo i del fytyra e saj engjëlllore që çdo ditë bëhet më e bukur, më e shndritshme, më e pa rezistueshme. Kur qëllon t'i buzëqeshë nga thellësia e banakut, ndizet flakë, nuk i intereson më as puna, as miqtë, asgjë, asgjë.

Nuk harron asnjëherë të hyjë në dyqanin ku merr fuqi, ripërtërin forcat, mendon bisedën me të.

Kurrë nuk guxon më shumë...

Më në fund ndodhi ajo çka dëshironte me aq zjarr. Gruaja ngre dorën, e përshëndet me lëvizje delikate të kokës, lë kompjuterin, afrohet buzagaz në cep të banakut.

- Të kam pritur, - i thotë, - sa shumë të kam pritur!

Zëri i mëndafshhtë, pak i ngjirur e godet si shpatë! Zot, sa herë ka dashur ta dëgjojë natën, sa herë e ka përfytyruar ditën për diell!

- Mua? - e pyet i habitur.

Ajo qesh, fytyra i ndizet nga një flakë hyjnore, buzët e tulta hapen si qershi.

- Nuk e ke kuptuar? - i pëshpërit rrëzë veshit, - ta kam thënë në njëqind mënyra!

Nuk ishte më ëndërr.

E shtunë, 4 prill 2020





## Gurëthemet historike të një romani

Nga Mira Meksi

Përherë kam dëshiruar të shkruaj një roman për Teutën e Ilirisë. Fillesat kanë qenë prej një pasioni të hershëm të fëmijërisë për “mbretëreshën luftëtare”, pasion që sigurisht ishte rritur me kalimin e viteve, duke u bërë më i plotë dhe më i pasur. Pasioni ishte ushqyer nga një mjegullinë misteri që e vishte Teutën: në librat për fëmijë dhe në shkollë mësonim se ishte mbretëresha legjendare e ilirëve që u bë tmerri i Romës dhe krenoheshim me të sepse ishte paraardhësja e ne shqiptarëve me histori përherë të lavdishme. Mirëpo nga bisedat e të rriturve, dikur më zuri veshi se Teuta kish pas qenë edhe pirate. Kjo kundërshti, për mendjen time fëmijërore, mbretëreshë dhe pirate njëherit (sepse domosdo pirateria kishte një kuptim shumë negativ), më ndezi një përfytyrim magjik, i cili krijoi në mendjen time aventura të pafundme: aventurat e amazonës ilire të deteve

me kurorë mbretëreshë në flokë, e cila s’kishte të dytë në faqe të dheut.

Për të realizuar projektin tim letrar, nisa të lexoja viteve të shkuara, gjithçka ishte shkruar për Teutën e Ilirisë, që nga autorët e lashtë, historianë, arkeologë, antropologë, etnologë, filologë, mitografë apo letrarë dhe gjer tek ata modernë. Zhgënjimi ishte i madh, kur pashë se të gjitha shkrimet për të mblidheshin në një grusht.

Autori më i famshëm që ka shkruar për Teutën është Polibi, por në traktatet e tij historike, më shumë vend u kushtohet komenteve që historiani dhe politikani grek bën për mbretëreshën ilire, sesa fakteve objektive historike. Në komentet e tij me ngjyresa të forta politike, dallohet qartë një lloj përbuzjeje për të. Edhe arkeologjia doli të ishte shumë e kufizuar në zbulimet e saj në lidhje me Teutën. Madje nuk ekziston asnjë statujë e vërtetë e saj, asnjë monedhë që të ketë të gdhendur

portretin e mbretëreshës së Ilirisë. Nga tërë objektet arkeologjike të gjendura në viset ilire, që nga fillimi i gërmimeve në shekullin XIX dhe gjer në ditët tona, nuk ka asgjë që Teuta ta ketë përdorur apo qoftë edhe ta ketë prekur me dorë. Të krijohej përshtypja se shkrimi i një romani historik për Teutën e Ilirisë ishte thjesht i pamundur.

Viteve që pasuan kuptova se kjo ndërmarje e madhe kërkonte një moshë të pjekur për t’u realizuar: kur të isha në gjendje të gjurmoja, të peshoja faktet historike dhe të gjeja raportin e duhur midis historikes dhe fiksionit, trillimit dhe fantazisë, për të krijuar një vepër letrare me sfond, ngjarje dhe personazhë historikë.

Ndonjëherë, lexuesit i shpëton paq e vërteta se historiani *nuk mund* të sillet tjetër veç si shkrimtar, ndërkohë që shkrimtari *mund* të sillet edhe si historian, të interpretojë faktet historike të cilat janë në dritë të diellit dhe njohin një shumësi interpretimesh. Se ndryshimi mes tyre është më së tepërmi çështje ndërgjegjeje dhe vetëdijeje: historiani *nuk* është gjithnjë i vetëdijshëm për këtë tipar të *pashmangshëm* të “zejes” së tij, ndërkohë që shkrimtari është gjithnjë i vetëdijshëm për *zgjedhjen* e tij...

Kuptova se më duhej një kohë e gjatë për t’u avitur kohës historike, shekullit III para Krishtit, botës ilire të asaj periudhe, që shënon edhe kulmin e lavdisë së shtetit ilir. Mbi të gjitha t’i afrohesha Teutës së Ilirisë, një personazh shumë kompleks dhe figurë emblematike: mbretëreshë, luftëtare, stratege, diplomate, mbi të gjitha, simbol i shpirtit ilir, çka e lidh me religjionin dhe besimin e ilirëve. Më duhej të gjeja një pike takimi me të, që kur të mbyllja sytë, të dy mijë vjetët të kalonin në çast dhe të mund ta përfytyroja të plotë, me gjithçka kishte jeta e saj.

Kështu nisi rrugëtimi im i gjatë përmes mijëra faqeve të autorëve të lashtë dhe modernë: Polibi, Herodoti, Diodori, Straboni, Apieni, Tit Livi etj., dhe Karl Patsch, Stipčević, Pierre Cabanes, Papazoglu, Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Vladimir Orel, Hasan Ceka, Selim Islami, Neritan Ceka etj. Dhe përmes trevave që mbajnë gjurmët e ilirëve, muzeumeve dhe zonave arkeologjike të Shqipërisë dhe të rajonit – Iliria e shekullit III para Krishtit, në mbretërimin e Teutës shtrihej që nga lumi Naro (sot Neretva, Kroaci) në veri, deri në gjirin e Ambrakisë (sot gjiri i Artës, Greqi) në jug.

Ekzistonte, megjithatë, një fill që e kapërcente kohën e frikshme prej mbi dy mijë vjetësh dhe më lidhte me Teutën, një fill që më mundësonte një lloj komunikimi me të: ishte gjuha shqipe. Përveçse i përkisnim racës njerëzore dhe ishim gra, Teuta dhe unë, kishim jo vetëm zemër, dashuri, urrejtje, frikë e plot ndjenja të tjera kësisoj, por edhe një gjuhë, apo një shëmbëlltje gjuhe që na bashkonte.

Shumë historianë dhe filologë, të huaj dhe shqiptarë, kanë arritur tanimë në përfundimin se shqipja është e vetmja gjuhë e gjallë që rrjedh nga gjuha ilire,

nga një degë e ilirishtes, prej të cilës nuk kemi ende asnjë gjurmë të shkruar.

Me këtë fill në dorë, gërmova thellë në tokën e kohës për të zbuluar rrënjë të gjuhës. Me durim të madh nxora një grumbull fjalësh të vjetra të shqipes, por edhe të greqishtes së vjetër të përziera me rrënjët e shqipes, të cilat do t’i përdorja për të krijuar klimën e ngjarjeve në romanin tim, sigurisht gjer në atë masë sa të mos e lodhja lexuesin tim, duke ia vështirësuar leximin. Do të doja të kujtoja se, një lëndë të vyer arrita ta peshkoj brenda dy veprave të Vladimir Orelit: *Rindërtimi i protoshqipes* dhe *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*.

Mijëra faqet e historianëve antikë dhe modernë për Ilirinë dhe qindra faqet për shkollat dhe pedagogët e Greqisë së lashtë, për *symposionet* (banketet), për qytetërimin grek, aq pranë dhe aq i afërt me qytetërimin ilir, për atë romak, për piraterinë e lashtë të Mesdheut dhe, sidomos, atë të Drakontoforonit (deti i gjarpërinjve), siç quhej lashtazi deti i Ilirisë, nuk mjaftonin për ta ndërtuar botën ilire. Atëherë nisa të gjurmoja legjendat, mitet, përrallat, rrëfenjat, gojëdhënat, gjithçka është mish i kujtesës së gjallë të Ballkanit... Labirintet e dijes ishin të pafundme, të errëta dhe të shumëkoklavitura. Me kohë mësova të orientohesha, të lëvizja në to dhe të bëja përpara, duke mbajtur në dorë pishtarin e alkimisë, magjisë, fantazisë dhe trillit romanesk.

U gjenda kësisoj, më në fund e pas shumë përpjekjeve, brenda kohës së dëshiruar, e cila më ndihmoi për të shkruar romanin, por që rezultoi të ishte një aventurë e rrezikshme për t’u jetuar. Shpesh kohët ngatërroheshin dhe përplaseshin me njëra-tjetrën – herë përjetoja një mrekulli të vërtetë, duke jetuar e struktur në shekullin III para Krishtit, dhe herë më kthehej në një torturë e një mundim të stërmadh dalja në sipërfaqe në këtë kohën tonë.

Në poçarinë time të krijimit, balta kish zënë të merrte formë për të krijuar ditë pas dite dhe vit pas viti Ilirinë e përbashkuar të gjysmës së dytë të shekullit III para Krishtit, e cila, nën sundimin e mbretit Agron dhe gruas së tij Teutës, u fut në histori krahas fuqive të mëdha të kohës: Greqisë, Egjiptit, Asyrisë, Kartagjenës, Makedonisë dhe Romës. Më tej, pas vdekjes së Agronit, mbretëresha Teutë e ktheu Ilirinë në një nga fuqitë detare dhe tokësore më të mëdha të kohës, duke ndihmuar, me bëmat e saj, - me pushtimet e saj, me kontrollin e porteve më të rëndësishme të Hadrias, dhe me nxitjen që i bëri Romës për të realizuar ëndrrën e saj të kahershme, kontrollin e Mare Nostrum, - hapjen e një faqeje të re në historinë e botës: perëndimin e Greqisë dhe daljen në skenë të Romës.

\*

Një nga mitet më të lashta greke që lidhet me simbolin e gjarpërit tek ilirët, është ai i shndërrimit në gjarpër të heroit grek, themeluesit të Tebës, Kadmit dhe gruas së tij, Harmonisë, bijës së hyut të luftës, Aresit. Gjurmët e para të këtij miti, në letërsi datojnë në shekullin V

para Krishtit, në tragjedinë e Euripidit "Bakantet", luajtur në Athinë më 405 para Krishtit. Më pas, tek Herodoti, në librin IX të *Historitë*, te Pseudo-Scylaxi, por edhe tek autorë të tjerë. Apolodori flet për zotin e Tebës, Kadmin, i cili u bë mbreti i popullit barbar (d.m.th., jogrek), lindi një djalë, që ia vuri emrin Ilyrios, nga ku mori emrin edhe populli barbar. Emri Ilyrios është i lidhur ngushtësisht me gjarprin, i cili e mbështolli foshnjën që në lindje me trupin e tij, duke i përçarur tërë vetitë dhe fuqinë e tij hyjnore — kështu gjarpri-hyjni, Ilyrios, u kthye në perëndinë krijuese të ilirëve, mbrojtësin dhe totemin e Ilirisë. Brezi prej argjendi i gjetur në një varr ilir në Selcën e poshtme (pranë liqenit të Ohrit), ka të gdhendur një skenë lufte: dy luftëtarë ilirë dhe hyun gjarpër, Ilyriosin, në plan të parë. Shumë zbulime të gjetura nga arkeologët nëpër nekroplet ilire, kanë formën dhe simbolikën e gjarprit. Një nga tempujt më të rëndësishëm të Ilirisë së lashtë ka qenë, sipas gojëdhënave, tempulli i Gjarprit hyjni. Miti ilir i gjarprit ka mbërritur gjer në ditët tona: jo vetëm në përrallat e moçme shqiptare (Mimikakliu, Feniçka etj.), në besimin se çdo shtëpi e vjetër ka edhe "mbrojtësin" e saj, që është "gjarpri i shtëpisë", apo "vitorja e shtëpisë", por edhe në motivet e veshjeve popullore shqiptare.

Mite dhe legjenda greke dhe ilire janë shkrirë me njëra-tjetrën, duke fshirë sinorët e tyre. Në gojëdhëna të lashta të Risanit (Rhizoni i lashtë) flitet për një mbretëreshë që kishte fuqinë e gjarprit, që dilte detit me një anije në formën e gjarprit, e cila rrëshqiste në ujë si gjarpër, dhe luftëtarët e zjarrtë që printe i kishin mburojat me emblemën e gjarprit. Nën këtë imazh legjende u formësuan edhe disa tipare të Teutës së romanit tim: ajo u kthye në mishërimin njerëzor të hyut Gjarpër të ilirëve, i cili, njëllon si në legjendën e famshme greke të Kadmosit, e mëkoi me limfën e tij, duke i dhënë dimensionin hyjnor. Sa për tiparet fizike, mbretëreshën ilire e përfytyrova njëllon siç përfytyronin grekët e lashtë perënditë e tyre: me flokë ngjyrë mjalti dhe sy prej qelibari. Teuta, e mburjtur dhe e edukuar me dijet më të përparuara të kohës, së pari bëhet faltarja e madhe e faltores së Gjarprit, institucionit më të lartë shpirtëror dhe mistik, por jo vetëm, të ilirëve, pastaj mbretëresha e Ilirisë shfaq një dykuptimshmëri të jashtëzakonshme, e cila është burim i një force dhe energjie

të madhe, por edhe burim konfliktesh tragjike dhe të gjakta: ajo është njeri vdekatar dhe njëkohësisht mban hyjnoren brenda vetes. Shpirti i saj i është përkushtuar Ilirisë, por zemra e saj prej gruaje i jepet pasionit të madh të dashurisë për një burrë. Pathosi dhe detyra sublime përplasen kaheër egrazi dhe dalin në logun e duelit. Nuk jemi shumë larg heronjve të Homerit. Është koha kur perënditë dhe njerëzit janë shumë pranë njëri-tjetrit dhe kufiri mes tyre është fare i brishtë.

Sipas historianit të lashtësisë Strabonit, dhe atij kroat, Aleksandër Stipčević, ilirët ishin mjeshtër të tatuazhit. Simbolet e tyre i vizatonin në lëkurë — nëpër nekropole janë gjetur veglore e tatuazhit, paraardhëset e denja të vegloreve të sotme. Në roman Teuta ka të skalitur në trup gjarprin Ilyrios, totemin e vendit të saj.

Për të shpalosur në gjerësi dhe, njëkohësisht, në detaje të holla jetën, ngjarjet, lavdinë e Ilirisë dhe të Teutës në vetëm tre vitet e sundimit të saj (230-228 para Krishtit, dashurinë pasionante, keqkuptimin tragjik, tradhtinë, robërinë dhe, në fund, vdekjen, më duhej një rrëfim përtej të zakonshmes, një rrëfim mitik. Është kujtesa e hyjnishme e gjarprit të skalitur në trupin e Teutës burimi i rrëfimit të këtij romani.

Gjithsesi, ngrehina e "Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë" është ndërtaur me gurët autentikë të historisë — personazhet, kronologjia e ngjarjeve dhe zhvillimeve historike, betejat, ideali i Teutës për të pushtuar Greqinë, vendin e saj shpirtëror, për të krijuar mbretërinë iliro-greke, si edhe qëllimi i saj i lartë për kultivimin e shpirtit ilir sipas një ideali të përcaktuar humanist. Brendësia e romanit — është histori, por edhe magji, fantazi, mite, gojëdhëna dhe legjenda.

"Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë" mund të quhet edhe romani i dashurisë *par excellence*: dashuria e Teutës së Ilirisë për gjeneralin Demetër Faros. Është një pasion zhuritës, i ngjizur me lëndë hyjnore, i sprovuar në zjarrin e betejave, por edhe i shenjuar nga tradhtia, nga keqkuptimi vdekjeprurës dhe me një fund tragjik.

Nuk mëtoj të kem dhënë në këtë roman të vërtetën historike mbi ilirët dhe Teutën e Ilirisë. Jam përpjekur të ndërtoj së brendshmi, siç ka thënë Marguerite Yourcenar-i kur shkroi "Kujtimet e Hadrianit", atë botë që arkeologët e ndërtojnë së jashtmi.

## Refleksion: vazhdimësi dhe risi në vëllimin "Paralele dhe kryqëzime" të Klara Kodrës

nga Hasan Gremi



Vëllimi me studime me titullin tepër shprehës "Paralele dhe kryqëzime" të studiueses Prof. Klara Kodrës, botuar nga Akademia e Studimeve Albanologjike (në 2018-ën, po që u fut në qarkullim vetëm tani), ka vazhdimësi në monografitë e saj për letërsinë arbëreshe dhe vëllimin saj të mëparshëm me studime "Rrenjë e lisit", kurse në këtë vëllim shfaq edhe një risi, depërton në shkencën letrare të krahasuar që ka filluar të lëvrohet tani vonë.

Studiuesja bën krahasime të veprave të letërsisë shqiptare me vepra të letërsive të kombeve ndryshme, italiane, frenge, greke, turke dhe persiane dhe me një paratekst me ndikim ndërkombëtar, Biblën; gjithashtu përpiket të vendosë disa autorë në kuadrin e letërsisë shqiptare apo të analizojë evolucionin e tyre në raport me vetveten.

Vëllimi rrok një hapësirë të gjerë historiko-letrare (40 vjet të krijimtarisë së saj, një shekull për sa u përket autorëve) dhe një hapësirë po aq të gjerë gjeografike (duke përfshirë letërsinë kosovare dhe diasporën arbëreshe), po gjerësia shkon paralelisht me thellësinë, meqenëse autorja gërmon thellë në formë për të nxjerrë në dritë literalitetin të lenë menjëanë gjatë nga kritika sociologjike.

Artikujt e kësaj përmbledhjeje gërshetojnë metodën sociologjike me elementë të analizës tekstuale. Një pjesë të artikujve i përkasin periudhës së para viteve '90, po nuk janë ripunuar thellë, meqenëse autorja ka menduar se ato qendrojnë.

Në vëllim ka hipoteza që hidhen për herë të parë si hipoteza për ta krahasuar "Adrinën" e De Radës me "Murgeshën" e Dideroit, për të krahasuar "Ervehën" e Kyçykut me novelën e nentë të ditës së dytë të "Dekameronit" të Bokaçios, për të evidentuar motivin bibliko-kuranor të fatit të Jozefit të Kyçyku dhe për ta krahasuar këtë autor me vepra të letërsisë turke e persiane. Për herë të parë Camaj shihet si lëvrues i llojit fantastiko-shkencor dhe romani "Oh" i Anton Pashkut kundrohet si ndërthurje e antiromanit me romanin ekzistencialist.

Studiuesja rimerr edhe krahasimin që bënte Arshi Pipa midis "Moisiut" të Nolit dhe atij të Alfred de Vinjisë, po për të nxjerrë përfundimin e kundërt me studiuesin tjetër, atë të origjinalitetit të Nolit si poet. Noli, sipas saj, nuk është vetëm gjeni rikrijues si pretendon Pipa, po edhe poet krijues.

Gjithashtu ajo ndalet në analizën e poetikave individuale si në ato të Skiroit dhe të Agollit. Studiuesja u kushton vëmendje autorëve që sollën modernitetin në letërsinë shqiptare si Anton Pashku dhe Camaj dhe në caqet e Shqipërisë, Petro Marko dhe Faik Ballanca. Gjithashtu ajo e pranon De Radën si pararendës të drejtimeve moderniste duke rënë dakord me Gradilonen dhe Kadarenë. Në vepër ka edhe krahasime midis autorëve të letërsisë së kultivuar dhe të letërsisë gojore "Zef Serembja dhe folklori", "Ruajtja e identitetit kombëtar përmes baladave epiko-lirike arbëreshe".) për të evidentuar ngajshmëritë dhe bashkëndikimet.


Ndonjë autor i njohur rishihet në aspekte të veta si Naimi në përmasën e vet erotike ose Dora d' Istria si studiuese e problemit të gruas. Romantizmi shqiptar kundrohet në origjinalitetin e vet mjaft të debatuar. Gjithashtu mjaft autorë shihen si "lëvrues të tokave të virgjëra" si Santori fabulist, lëvrues i satirës dhe romancier, Camaj lëvrues i llojit fantastiko-shkencor apo utopik.

Disa hipoteza të autores janë të diskutueshme, po studiuesja përpiket t'i argumentojë.

Në vepër ka autorë që rivlerësohen ose vlerësohen për herë të parë. Studiuesja është e bindur për vlerat europiane të letërsisë shqiptare dhe i evidencon ato.

Vëllimi, pra, ka meritën e origjinalitetit dhe të një synimi drejt objektivitetit, ndonëse autorja që është edhe poete, jo rrallë rrëmbehet nga pasioni në analizat e saj.





## EDUARDO GALEANO

### Pse shkruaj

Dua të flas pak për si dhe pse u bëra shkrimtar.

Në fillim një pohim: Qysh fëmijë, jam përpjekur të bëhem futbollist. Jam ende numri një. Më i miri nga më të mirët, por vetëm gjatë gjumit, ndërsa fle, sepse porsa zgjohem, pohoj që kam këmbë prej druri dhe s'kam asnjë mundësi tjetër përveçse të përpiqem të jem shkrimtar.

Kam bërë dhe bëj gjithçka mundem të them më shumë me më pak, duke kërkuar fjalë që janë më të mira dhe më të mençura se heshtja, fjalë të zhveshura nga retorika. Shkrimi ka qenë, dhe ende është, mjaft i vështirë, por shpesh më bën të përjetoj

ndjenja të thella dhe kënaqësi të madhe, larg vetmisë dhe harresës.

Kam bërë dhe bëj gjithçka mundem të jem i aftë të mësoj si të fluturoj në errësirë, të vjell gënjeshtër që jemi të detyruar të gëlltisim çdo ditë, dhe të jem i pabindur kur zotërit e botës japin urdhëra që i kundërvihen ndërgjegjes time dhe gjykimi të shëndoshë.

Kam bërë dhe bëj gjithçka mundem të mendoj se s'mund të jem asnjans, dhe s' mund të jem objektiv sepse nuk dua të bëhem objekt, shpërfillës ndaj pasioneve njerëzore.

Kam bërë dhe bëj gjithçka mundem të denoncoj atë proverbin e vjetër që thotë se Njeriu është ujku i Njeriut. Gënjeshtër. Ujqërit nuk vrasin kurrë ujqer, dhe ne jemi kafshët e vetme që specializohen në shfarosjen e ndërsjelltë.

Kam bërë, bëj gjithçka mundem, të shkruaj për zbulimin e grave dhe burrave që kanë vullnet për drejtësi dhe për të bukurën, ata janë bashkëatdhetarët dhe bashkëkohësit e mi, pavarësisht se ku u lindën apo kur jetuan, përtej kufijve të kohës.

Kam bërë, bëj gjithçka mundem, të jem aq kokëfortë sa të vazhdoj të besoj, pavarësisht të gjitha dëshmimeve se ne njerëzit jemi krijuar keq, sepse jemi ende të papërfunduar.

Kam bërë gjithçka mundem, dhe shpresoj se do të përpiqem gjithmonë, të zgjedh anën e duhur, e cila ndodh të jetë në luftën e përjetshme të zemëratës kundër zemëratës.

Kam bërë, bëj gjithçka mundem. Ia vlen, më besoni. Ne mund ta ndryshojmë atë fjali të famshme të shkruar nga shoku im, Billi...Bill Shekspiri: "Jeta është përrallë e rrëfyer prej një të marri, plot bujë dhe tërbim, pa kurrfarë kuptimi!"

Pse u bëra shkrimtar

Dua t'ju tregoj historinë e sfidës sime të parë të vërtetë si rrëfimtari, herën e parë kur pata frikë se mos ndoshta nuk isha në lartësinë e detyrës. Ndodhi në qytetin bolivian të Llallagua-s. Kalova ca kohë atje, afër minierës. Ishte vendi ku ndodhi masakra e San Juanit, kur diktatori Barrientos urdhëroi trupat të hapnin zjarr nga lartësitë e kodrave përreth, ndaj minatorëve që ishin duke pirë dhe vallëzuar në vigjilje të Shën Gjonit.

Mbërrita rreth një vit më vonë, në vitin 1968-të, dhe qëndrova për ca kohë falë aftësive të mia si artist. Gjithmonë kisha ndjerë një nxitje për të vizatuar, megjithëse skicat e mia kurrë nuk arritën të mbyllnin hendekun midis vetes dhe botës.

Humnera më e madhe ishte midis aftësive dhe synimeve të mia, megjithëse disa nga portretet e mia dolën mirë dhe isha i mirë në vizatimin e gërmave. Në Llallagua vizatova portrete të fëmijëve të minatorëve dhe pikturova postera për karnavale, për ngjarje publike, çfarëdo gjëje që duhej. Kështu që qyteti më birësoi, dhe kalova shumë mirë në atë botë të mjerë, të ngrirë, ku të ftohtit e bën më të ashpër varfërinë.

Nata e largimit tim mbërriti. Minatorët ishin miqtë e mi dhe më organizuan një festë lamtumire me shumë pije. Rrëkëlljem *chicha* dhe *singani*, një lloj grape e shijshme por disi e padurueshme. Po festonim, këndonim, bënim shaka, dhe gjatë gjithë kohës e dija që në orën pesë ose gjashtë të mëngjesit, sirena do të shpërthente, duke i thirrur ata të nisnin punën në minierë, dhe do të mbaronte gjithçka. Do të ndaheshim.

Kur u afrua çasti, më rrethuan sikur po më akuzonin për diçka. S'po më akuzonin për asgjë, por më thanë: -Tani, na trego për detin.

Mbeta pa fjalë. Minatorët u dënuan me një vdekje të hershme nga silikoza në thellësi të tokës. Në ato kohë jetëgjatësia në pusët e minierës ishte 30 ose 35, jo më shumë. Ata kurrë nuk do ta shihnin detin, do të vdisnin pa asnjë mundësi për t'i hedhur sytë nga ai, ishin paracaktuar të mbeteshin në qytezën e mjerë të Llallagua-s. Detyra ime ishte ta sillja detin tek ata dhe të gjeja fjalë e dhura që të zhyteshin në të.

Kjo ishte prova ime e parë si rrëfimtari dhe më bindi që përballja me të ia vlente.

Përktheu: Ejëll Miraka



# TOMAS TRANSTRÖMER

## Kujtimi im i parë

“Jeta ime”. Kur i mendoj këto fjalë parasysh më shfaqet një rreze drite. Në një vështrim më të afërt rreza e diellit ka formën e një komete me kokë dhe bisht. Skaji më i ndritshëm, koka, është fëmijëria dhe rinia. Bërthama, pjesa më e ngjeshur, është fëmijëria shumë e hershme kur përcaktohen vetitë më të rëndësishme të jetës sonë. Përpiqem ta kujtoj, përpiqem të depërtoj aty. Por është e vështirë të lëvizësh në këto regjione të dendura, është e rrezikshme, më duket sikur afrohem afër vdekjes. Kah fundi kometa hollohet – është pjesa më e gjatë, bishti. Ajo bëhet më e rrallë por edhe më e gjerë. Tani jam larg në bishtin e kometës, jam gjashtëdhjetë vjeç kur po e shkruaj këtë.

Përjetimet më të hershme në pjesën më të madhe janë të pakapshme. Ritregimi, kujtimet e kujtimeve, rekonstruktionet e bazuara nga atmosferat ndezura befas.

Kujtimi i parë i shënuar është një ndjenjë krenarie. Sapo kam mbushur tre vjet dhe më kanë thënë se është shumë kuptimplote se tani jam rritur. Qëndroj shtrirë në shtrat në një dhomë të ndriçuar dhe pastaj zbres në dysheme, jashtëzakonisht i vetëdijshëm se po bëhem i madh. Kam një kukull të cilën e kam pagëzuar me emrin më të bukur që kisha mundur ta gjeja: KARIN SPINNA. Nuk e trajtoj si fëmijë. Për më tepër ajo është një shoqe, një dashuri.

Ne banojmë në lagjen Söder të Stockholmit, në adresën Swedenborgsgatan 33, (tani Grindsgatan). Babai akoma është pjesë e familjes por së shpejti nuk do të jetë më. Stili është mjaft “modern” – që nga fillimi unë i thërras prindërit e mi me “ti”. Në afërsi janë gjyshja dhe gjyshi, ata banojnë në këndin e rrugës Blekingegatan.

Gjyshi, Carl Helmer Westerberg, u lind më 1860. Ai ishte drejtues anijesh dhe shok im shumë i afërt, 71 vjet më i madh se unë. Çuditërisht edhe ai kishte një raport të njëjtë në dallim moshe me gjyshin e tij, i cili ishte i lindur më 1789: Bastilioni sulmohet. Revolta e Anjalës, Mozarti komponoi kuintetin për klarinet. Dy hapa poaq të mëdhenj prapa, dy hapa të gjatë, ndonëse jo edhe aq të gjatë. Mund ta prek horizontin.

Gjyshi fliste me gjuhën e shek. XVIII-të. Shumë shprehjdh sot do të merreshin vetveti të vjetruara. Në gojën e tij, dhe për mua, tingëllonin shumë të natyrshme. Ai ishte një burrë trupshkurtë, me mustaqe të bardha dhe me një hundë të mprehtë, paksa të lëshuar – “si një turk” siç thoshte vetë. Nuk është se ai nuk ishte temperament dhe nuk nxehej. Një shpërthim emocional nuk merr asnjëherë seriozisht dhe kalonte menjëherë. Në të vërtetë ai ishte aq paqësor sa ekzistonte rreziku të cilësohej si i pavendosur. Ai dëshironte të mbante qëndrim parimor edhe për personat që nuk ishin të pranishëm, për ata që përfoleshin gjatë bisedave të zakonshme.

- Por, baba mbase duhet ta pranosh se X është një maskara!

- Dëgjo, kjo nuk më është e njohur.

Pas divorcit nëna ime u shpërngul në rrugën Folkungsgatan 57, një shtëpi për shtresën mesme.

Aty banonin njerëz të ndryshëm shumë afër me njëri-tjetrin. Kujtimet për shtëpinë strukturohen afërsisht si një film i viteve 30-ta apo 40-ta, me një galeri personazhesh që do të veprojnë aty. Gruaja e dashur e rojës në hyrje, e rojtarit të fuqishëm të cilën e adhuroja ndër të tjera se ishte i helmuar me gaz – tregonte një afërsi timen heroike ndaj njerëzve të rrezikshëm.

Ishte një qarkullim i rralluar i të paaftëve. Ndonjëri nga pijanecët mund të ngrihej sërish në hyrje të shkallëve. Në derë trokisnin lypsarë disa herë në javë. Qëndronin duke murmuritur korridorit. Nëna u afronte ndonjë sendviç – u jepte rriska buke në vend të parave.

Ne banonim në katin e pestë, pra në katin më të lartë. Ishin katër dyer, përveç derës së tarracës. Në njërin nga dyert shkruante Orke, një fotoreporter gazete. Në njëfarë mënyre ishte fascionuese të banoje përballë një fotoreporteri.

Fqinji ynë më i afërt, ai që dëgjohej nga ana tjetër e

murit, ishte një burrë i pamartuar, mesoburrë, me lëkurë të zbehur. Ai kishte profesionin në shtëpi, një lloj agjencie telefonash. Gjatë bisedave telefonike të qeshurat dhe gajasjet e tij depërtoni këndej murit. Një zë tjetër që vinte vazhdimisht ishte shpërthimi tapave, shishet “Pilsner” në atë kohë nuk kishin kapsula. Këta tinguj dionisianë, gajasja dhe shpërthimi i tapave, dukej sikur nuk përshtatej me xhaxhain e zbehtë si hije të cilin e takoja nganjëherë në ashensor. Me kalimin e viteve ai u bë person më i dyshimtë dhe gajasjet e tij më të rralluara.

Një herë shpërtheu në agresivitet. Isha i vogël. Një fqinjin tonë e kishte dëbuar nga banesa gruaja e tij, ai ishte i dehur dhe i zemëruar, ndërsa gruaja kishte barrikaduar veten. Ai përpiqej ta thyente derën duke bërthituar dhe kërcënuar.

Atë që mbaj në mendje është bërtitja e tij me këto fjalë të çuditshme:

- Në djallë, aq më bënë se shkoj në Kungsholmen!

- Çfarë mendon ai me Kungsholmen? Pyesja nënën.

Ajo më shpjegonte se në Kungsholmen ishte stacioni i policisë.

Lagja jonë përjetoi një ngjarje të tmerrshme. (Erdhën përforsime të mëtejme kur unë vizitoja Spitalin e Shën Erikut dhe shikoja episodet e luftës nga Finlanda që mjekoheshin aty në dimrin e vitit ‘39-‘40.)

Nëna shkante në punë herët në mëngjes. Ajo nuk merrte makinën, por shkante gjithnjë në këmbë. Gjatë gjithë jetës ajo kishte ecur deri në punë, mes Söder dhe Östermalm – ajo punonte në çerdhen e fëmijëve Hedvig Eleonora dhe kujdesej për klasën e tretë dhe të katërt gjeneratë pas gjenerate. Ajo ishte një mësuese e përkushtuar dhe i donte shumë fëmijët. Mund të supozohet se ajo do ta kishte të vështirë kur të pensionohej, Por nuk ishte ashtu; ajo ndjeu një lehtësim të madh.

Nëna, pra, punonte në profesionin e vet dhe ne kishim shërbëtore në shtëpi, apo “dado” siç quhej atëherë, ndonëse do të duhej të quhej kujdestare. Ajo flinte në shtëpinë tonë në një dhomë tepër të vogël që ishte ngjitur me kuzhinën dhe nuk llogaritej në hapësirën e banesës dy-dhomëshe me kuzhinë siç ishte e shkruar në zyrtarisht në kontratën e banesës sonë.

Isha 5-6 vjeç, kujdestarja e shtëpisë quhej Anna-Lisa dhe ishte nga qyteti Eslöv. Më dukej se ajo ishte shumë tërheqëse:

me flokët e bardha kaçurrel, me hundën e drejtë, me një të folur të butë në dialektin skonsk. Ishte një njeri i hareshëm; edhe tani ndjej diç të veçantë kur kaloj pranë stacionit Eslöv. Por asnjëherë nuk kam zbritur në atë vend magjepsës.

Kishte aftësi të vizatonte shumë bukur. Ishte mjeshtre për të vizatuar figurat Disney. Unë vizatoja pothuaj vazhdimisht gjatë këtyre viteve, fundi i viteve 30-ta. Gjyshi sillte në shtëpi tuba të bardha letrash aso që përdoshin nëpër të gjitha dyqanet e asaj kohe, dhe unë i mbushja letrat me seri vizatimesh. Kisha mësuar natyrisht shkronjat në moshën 5-vjeçare. Por shkrimi shkante ngadalë. Fantazia kërkonte mjete më të shpejta shprehëse. As për të vizatuar nuk e kisha durimin e duhur. Unë e zhvillova një skenografi figurash me trupash në lëvizje të dhunshme dhe dramatikë të rrezikshme, por të padetajuar. Ishin seri vizatimesh që konsumoheshin vetëm nga unë.

Diku kah mesi i viteve të 30-ta kam humbur mu në qendër të Stockholmit. Nëna dhe unë kishim qenë në koncertin e shkollës. Në turmën pranë Shtëpisë së Koncerteve, jam shpëputur nga dora e nënës. Turma e njerëzve më kishte bartur tutje pa u vërejtur ngaqë isha i vogël. Ishte rënë muzgu në sheshin Hötorget. Kam qëndruar aty shumë i shqetësuar. Kishte njerëz gjithandej por ishin të zënë me punët e tyre. Nuk dija kah të drejtohesha. Kjo ishte ndjesia ime e parë për vdekjen.

Pas një çasti paniku fillova të mendoja. Duhet të jetë e mundur kthimi në shtëpi. Absolutisht e mundshme. Ne kishim ardhur me autobus. Kisha qëndruar ulur në gjunjë në ulësen e preferuar duke vështruar jashtë dritares së autobusit. Kishim kaluar nëpër rrugën Drottningsgatan. Tani duhej vetëm të kthehesha rrugës së njëjtë, stacion pas stacioni.

Po shkoja në drejtimin e duhur. Nga rruga e gjatë në këmbë më kujtohet qartë vetëm një episod: arrita tek Norrbro dhe pashë ujin. Trafiku ishte i dendur dhe nuk kisha guxim ta kaloja rrugën. I u drejtova një burri aty pranë meje, duke i thënë:

“Këtu ka shumë vetura”. Ai më mori përdore dhe më përcolli derisa kalova rrugën.

Por pastaj ai më la aty. Nuk di përse ai dhe të gjithë të rriturit të panjohur aty, pra nuk di pse mendonin që ishte çdo gjë në rregull që një djalë i vogël ecte vetëm nëpër Stockholm në mbrëmjen e errët. Por kështu ishte. Rruga e mbetur – nëpër Gamla Stan, Slussen dhe nëpër Söder duhet të ketë qenë e ndërlikuar. Mbase shkoja drejt caktit me anë të një kompas misterioz që kanë qentë dhe pëllumbat e letrave – ata gjithmonë e gjejnë vendin e kërkuar pavarësisht ku i lëshojmë. Nuk më kujtohet asgjë rreth kësaj pjese. Po, që vetëbesimi im rritej vazhdimisht dhe kur arrita në shtëpi isha në një gjendje dehjeje. Gjyshi ishte i qetë. Nëna e thyer kishte qëndruar në polici duke përcjellë vëzhgimet. Nervat e buta të gjyshit nuk e tradhtuan; ai më pranoi i qetë. Ishte i gëzuar kuptohet, por nuk e dramatizonte. Çdo gjë rrodhi mirë dhe natyrshëm.

përktheu: Qerim Raqi





# Njëzet e një mjeshtra për procesin krijues

## 1. Cilat janë kërkesat e zëjtarisë së romanit?

BERNARD CLAVEL

“Të jesh romancier, nuk do të thotë të të vijë ndoresh për të shkruar; talenti mund të farkëtohet dhe falë punës. Mirëpo, ç’prisni ju të farkëtoni në qoftë se nuk keni hekur? Ju mund ta rrihi vazhdimisht kudhrën, çka mund t’ju bëjë të përftoni muzikë të këndshme, por një gjë e këtillë nuk do të japë asnjëherë fryt të mirëfilltë farkëtimi. Për të qenë romancier, duhet të kesh tharme, rrëfenjëza për t’i shkoqitur, personazhe për t’u dhënë jetë e gjallëri; me një fjalë, duhet të mbartësh një botë. Ajo çka më pikëllon, sidomos, është fluturakëria me të cilën një ditë të bukur shumëkush i premtos vetes se ka për t’u bërë romancier sa hap e mbyll sytë. Ndryshimi midis këtij zanati dhe të tjerëve ngërthen pikërisht faktin e përvetësimit të tij fillikat”.



## 2. A duhen përcaktuar çaste të shkruari?

MARIO VARGAS LLOSA

“Unë punoj gjithmonë mëngjeseve dhe shkruaj përherë me dorë. Për mua orët e para të agullimit janë më krijueset. Kështu, nuk punoj kurrë më tepër se dy orë. Fill pas kësaj, zë e shtyp në makinë atë që kam shkruar, duke e ndryshuar disi tekstin, çka përbën njëfarësoj, korrigjimin e parë. Por, lë gjithmonë, disa rreshta të pashtypura, me qëllim që të nesërmen ta nis përnjimend ditën time të re të punës, duke shtypur fundin e dorëshkrimit tim të një dite më parë. Kjo çon në një lloj dinamizmi, si njëfarësoj gjimnastike shkrythëse a si diçka e këtillë. Më i vështirë më duket gjithmonë fillimi. Mëngjesi është rinisja e takimit, aq i ankthshëm. Mirëpo, kur ke për të kryer disa veprime mekanike, thuajse ia ke nisur nga puna. Makina nis të funksionojë. Unë kam një disiplinë të rreptë pune: çdo mëngjes, gjer në orën dy të pasdrekës, qëndroj në zyrën time të punës”.



## 3. Të shkruash me dorë apo me makinë?

ROLAND BARTHES

“Unë i shkruaj gjithnjë me dorë tekstet e mia, meqë i prish e i korrigjoj shumë. Mandej, është thelbësore për mua që t’i radhis vetë në makinën e shkrimit, pasi sakaq ia beh një valë tjetër korrigjimesh, korrigjime që priren vazhdimisht

në kahun e elipsit a të shuarjes. Vjen çasti kur ajo çka është shkruar, e cila qëndron shumë subjektive në pamjen grafike të dorëshkrimit, të objektivizohet: nuk është ende një libër a një artikull, por në sajë të shkronjave të shtypura në makinë shkrimi, përftohet tashmë një pamje objektive e tekstit dhe kjo është diçka shumë e rëndësishme”.



## 4. Ku të qëmtosh ide?

RAINER MARIA RILKE

“Shmangini temat e mëdha, për të rrokur ato që u shpalos përditshmëria juaj; rrëfeni pikëllimet dhe ëndjet tuaja, mendimet ikanake dhe besimin brenda bukurisë, cilado qoftë ajo, thuajeni gjithë këtë me çiltëri të kulluar, të thellë, të thjeshtë dhe për t’u shprehur, përdorni gjërat që iu rrethojnë, pamjet e ëndrrave dhe sendet e kujtimeve tuaja. Nëse përditshmëria iu duket e varfër, mos e akuzoni, por vini më mirë me shpatulla pas murit, vetëm veten tuaj; thuajeni vetes që nuk jeni aq poet sa t’i nxirrni asaj në pah pasuritë, sepse për krijuesin nuk ka varfëri, as vend të shkretë a mospërfillës. Dhe po të ishit vetë në një burg, muret e të cilit nuk do të linin të depërtonin në shqisat tuaja asnjë fije zhurmë nga kjo botë, a nuk do t’u mbetej fëmijëria juaj, kjo pasuri e rrallë, mbretërore, ky thesar kujtimesh? Në këtë rrafsh do t’ju duhet të çapiteni me këmbëngulje”.



## 5. Si mund të buisë mendimi për një roman?

JEAN ECHENOZ

“Në përgjithësi kjo zë fill te një skenë. Gjer më tani, kjo gjë ka ngjarë kështu. Është një skenë që e kam në kokë ose që e kam mbajtur shënim, por gjithmonë shumë kohë më parë, madje disa herë, shumë vite para se të nisja librin. Ajo i shërben paksa si mbujtëse romanit. Nuk ka fare të bëjë me ardhmërinë e romanit, është tepër arbitrare, por përbën pikën e tij zanafillore. Tek e fundit, ajo ose nuk do të rimerret fare në libër ose nuk do të bjerë aspak në sy: nuk do të jetë as i njëjti vend, as e njëjta periudhë, as të njëjtët personazhe. Në të do të ngjasë diçka krejt tjetër. Por është kjo skenë që shërben si nxitëse, shpërthyes. Është kjo, dhe fill pas saj, një mori gjërash që grumbullohen, mendime personazhesh, përshkrime, grimca bashkëbisedimesh. Kur e shoh që kam mjaft pikëmbështetje dhe e gjitha nis e mbruhet, libri mund të nisë. Për fjalinë e parë e vras mendjen, kur duhet të nis nga puna. Ajo zë e turet pak a shumë...”



## 6. Si të fillosh?

MARIO VARGAS LLOSA

“Para gjithçkaje, ngjet një ëndërritje, një lloj ripërtytje përreth një personazhi, një rrethane, diçka që shtjellohet vetëm në mendje. Më pastaj, zë e mbaj shënime, përpiloj skeda, thur pjesëza rrëfimtare: një personazh hyn në skenë këtu e del më tej, bën këtë a atë gjë; po kështu dhe për një tjetër: hyrje këtu e dalje atje. Mandej i shtjelloj këto grimca më hollësisht. Dhe kur ndërkohë bëhem gati t’ia nis nga puna me vetë librin, parashtroj, së pari, një skenë të përgjithshme të rrëfimit, të cilës nuk i përmbahem kurrë, pasi e përpunoj plotësisht më pas, por që, gjithsesi, më jep dorë për t’i hyrë punës. Pastaj nis të redaktoj shumë shpejt, pa pushim, pa kushediçfarë përkujdesje për stilin, gati të rrëfej shpesh herë të njëjtat episode, të mbruj situata krejtësisht kundërshtore... Kjo lëndë bruto më vlen, më siguron. Është pikërisht kjo pjesë e punës që më vë më tepër në siklet. Pasi mbërrij në këtë stad, çapitem vazhdimisht në kthetrat e një shqetësimi të madh, gjithmonë i pasigurt për përfundimin. Është plotësisht e vërtetë që variantin fillestar e shkruaj i përpirë nga ankthi i plotë. E mandej, me të kryer këtë, gjithçka ndryshon. Ndërkaq, fitoj sigurinë që rrëfenja ime është e gjitha aty, ngërthyer në atë që unë e quaj magma ime”.



## 7. A duhen mbajtur shënime?

FRANCIS SCOTT FITZGERALD

“Kur sjell diçka nëpër mend, sa herë që të kujtohet diçka, mbaje shënim gjithçka në bllokun përkatës. Por shënoje në po atë sekondë që e mendon. Askush nuk të siguron që herën e dytë do të hasësh të njëjtin intensitet”.



## 8. A duhet të njehsohemi me personazhet tona?

MAX JACOB

“Mos i zini besë karakterit tuaj në prozë dhe përdoreni gjithë fjalorin pa parapëlqim të posaçëm. Personazhet tuaja nuk duhet t’ju ngjasojnë ose t’ju shëmbëllojnë sa më pak. Ato duhet të përngjasojnë me vetveten. Kësisoj, fjalët tuaja nuk duhet të jenë “ju” por ato. Po kështu, ju nuk do të përshkruani objektin që iu pëlqen juve, por atë që u vjen atyre më për hosh, si dhe rrethana që iu shkojnë më për mbarë. Kujdes, pra!”



## 9. A duhet zgjedhur një pikëpamje?

DAVID LODGE

“Një trillim rrëfimtari nuk ka kurrfarë fati të na bëjë për vete, po nuk e ditëm kush flet dhe për kë. Duhet pranuar se përzgjedhja e pikëpamjeve, nga të cilat shtjellohet rrëfenja, përbën vendimin më parësor, që duhet të marrë romancierin, sepse kjo ngërthen mënyrën se si do të kundërveprojnë lexuesit, në rrafshin përjetues dhe moral, ndaj personazheve të trilluara, ndaj personazheve të trilluara dhe veprimeve të tyre. Bie fjala, rrëfimi i një kurorëshkeljeje, cilado qoftë, na bën tjetër përshtypje kur shihet nga personi kurorëshkelës, nga pjesëtari i çiftit që është pra ose nga dashnori a dashnorja, mbase dhe nga një i tretë krejt asnjans. Një autor përtaq a pa përvojë bie shpesh në grackën e mungesës së kthjelltësisë në përpunimin e pikëpamjes. Të kuptohemi, nuk ekziston ndonjë ligjësi a rregull që ta pengojë një romancier të ndërrojë pikpamje sa herë që t’ia ketë ënda. Mirëpo, nëse ky ndryshim ia beh pa plan a parim estetik, pjesmarrja e lexuesve në tekst, “përthithja” e kuptimit të tij nga ata, cënohet keqas”.



## 10. A duhet parashikuar një plan i përcaktuar?

MICHEL BUTOR

“Unë e di mirë se ku shkoj, por jo se si po shkoj! Këtu pikërisht vjen në ndihmë përfytyrimi, rastësia e fantazia. Unë nuk mund të shtjelloj një vepër trillimi para se të kem studiuar ndërthurjen për muaj me radhë. Në fillim, ekziston gjithmonë një hapësirë e mugët për t'u ndriçuar, terratira për t'u përshkuar: për të parë qartë, unë grumbulloj, së pari, gjithfarëlloj skemash. I pajisur me këto instrumenta, busulla nis eksplorimin. Me rishikime të njëpasnjëshme, sepse vetë skemat e mia njohin dora-dorës përparime, në të mirë të zbulimeve që bëj: sistemi është ndryshon njëherësh me organizmin, çdo tjetërsim detaji çon me doemos në ndryshueshmëri të së tërës. Si rrjedhojë, unë nuk e di gjithmonë se ç'ngjet në libër, nuk mund ta përmbledh pa e përfunduar. Libri quhet i përfunduar vetëm pasi shtrohet. Kur në sajë të rileximeve të ngjasoj se nuk më mbetet ç't'i gdhend më tepër”.



## 11. Si të zgjedhësh emrat e personazheve?

JULIEN GREEN

“Unë jam lexuesi i parë dhe nuk dua t'ia cenoj qejfin vetes: rrëmbehem nga libri që lind. Në këtë çast po shkruaj një roman të ri. Ai tashmë, përmban më shumë se pesëqind faqe, kurse unë kam përshtypjen se jam ende vetëm aty nga fillimi. Këtë gjë do ta marr vesh vetëm pasi ta kem përfunduar. Unë krijoj personazhet, kurse personazhet krijojnë romanin. Kësisoj kam punuar gjithmonë”.

JACQUES LAURENT

“Në përgjithësi romancierët janë shpjeguar shumë pak në zgjedhjen e emrave të personazheve të tyre. Unë provoj emrat, siç do të provoja këpucët. Ky nuk shkon, ky s'para vete, kur, hop, gjej një emër që i ngjet personazhit tim. E di që ai ngjit, pasi atë çast personazhi im ekziston. Sakaq, ndihem mirë me të”.



## 12. A mund të shkruhet një poezi kurdo e kudo?

ROBERT SABATIER

“E ndjej fizikisht se grishemi kam nevojë të shkruaj një poezi e kjo më ngjet gjithandej, kurdo: në agshol, në ndonjë kafene, në një çast vetmie, në metro... Bie në të thella e sakaq ia behin fjalët, më pas, dhe fërgëllimat... Mjaft të kesh një fletë letër... Unë mbaj gjithmonë me vete bllokun e çeqeve dhe rrallë qëllon që ta ketë kapakun të pashkaravitur me shkarrashkrimet e mia. Madje, ndodh që më shkojnë dem një a dy çeqe. Nuk do të qe keq të bëhej ndonjë studim mbi rëndësinë e bllokut të çeqeve në poezi!”



## 13. A duhet të jesh në shijen e ditës?

NATHALIE SARRAUTE

“Kur nisa të shkruaj, miqtë e mi më të mirë më thoshin: “Unë nuk përjetoj asgjë të këtyllë, nga e poftise këtë gjë që nuk përbën më asnjë realitet?” E megjithatë, unë vazhdova. Pastaj më vonë, dhe kundër kritikave. Para “romanit të ri”, asgjë nuk më joshite, meqë nisa pikërisht të shkruaja artikujt e “Era e dyshimit”, për t'i pohuar vetes përse kisha nisur të shkruaja në hullinë që kisha zgjedhur. Unë shumë mirë mund të mos u vë emra personazheve të mi ose dhe t'u vë, si të “Planetari”, pasi njerëzit shihen si pamje dhe se ata i përdorin emrat kur flasin për shoshonin. Mirëpo në të dyja rastet, përzgjedhja ime përkon me një nevojë të njimendët dhe jo me ndonjë lloj rregulli që i kam vënë vetes. Ma ha mëndja se kurrë nuk i jam përmbajtur modës.

Shkrimtarët me vizion kryekëput vetjak, duke u tallur me shijen në modë e duke shkruar shumë më larg, e afirmojnë gjithmonë veten”.



## 14. A mund të shkruhet shpejt e mirë?

CHARLES BAUDELAIRE

“Sot duhet prodhuar shumë. Lypset, pra, nxitim. Por nxitim i shtruar, me qëllim që të gjitha përpjekjet të jenë të mbrothta.

Për të shkruar shpejt, duhet të kesh menduar gjatë, ta kesh mbartur një subjekt brenda vetes, në shëtitje, në banjë, në restorant, thuajse edhe te dashnorja, madje. Eugène Delacroix më thoshte një ditë: “Arti është diçka aq ideale dhe aq ikanake, saqë veglat nuk janë kurrë dhe aq të përshtatshme, as mjetet aq të volitshme”.

“Kështu është dhe me letërsinë”.



## 15. A duhet ta shqetësojë shkrimtarin morali?

FRANÇOISE SAGAN

“Ekziston një censurë kur dëshiron të japësh imazhin e vetes. Mirëpo shkrimtari është dikush që don të dijë. Ai e nis një rrëfenjë dhe ia kënda të mësojë se çka do të ngjasë të nesërmen. Disa shkrimtarë nuk duan që të ndodhë gjëkafshë. “Po ta shkruaj këtë, çdo të mendojnë për mua?”. Nëse shkrimtarëve nuk do t' u bihej më qafë, nëse personi fizik, jeta e tyre shoqërore, nuk do të ngacmoheshin çdo çast nga televizioni, radioja, shtypi e kësodore, letërsia do të ishte shumë më pasionante. Trajta e censurës më duket sot më e saktësuar. Shkrimtarët dëshirojnë të jenë moralistë, duan të shfaqen si njerëz të drejtë, të kuptueshëm, tolerantë, me një fjalë, si njerëz për së mbari. Ata harrojnë që i vetmi moral është, para së gjithash, estetika, bukuria. Atyre ua ka qejfi të jenë në përputhje me disa kritere antikonformizmi. Jetojmë në një shoqëri empirike, materialiste. Gjithçka duhet të shërbejë, të jetë e dobishme. Por letërsia nuk shërben për kurrëgjë. Kjo nuk përbën as objektin, as natyrën e saj. Po shkruam me mendimin se jemi pasqyrimi i një shoqërie a një vagon i trenit historik, na gënjen mendja. Shkrimtari nuk duhet t' i shërbejë epokës së tij, por ta përdorë atë”.



## 16. Si të vishemi para se t' ia nisim të shkruarit?

GABRIEL GARCIA MARQUEZ

“Për të shkruar unë vishem me kominoshe mekaniku, sepse është veshje e rehatshme. Kominoshet janë veshja më praktike që është shpikur ndonjëherë për punë. E vesh në mëngjes, një mbyllje e thjeshtë zinxhiri dhe hop...”.

FRANÇOIS BOT

“Të shtunën e të dielën në mëngjes, unë jam i veshur me pizhama, por sapo më qaset ndonjë ngecje, shkoj bëj një dush, vishem e, më pas, gjithçka merr sërish udhë...”.



## 17. Ç'duhet të lexojë një shkrimtar i ardhshëm?

JULIEN GRACQ

“Kush është i vendosur për të shkruar ka një çast, çast vendimtar, për formimin e tij - kur ai lexon gjithçka, a thuajse, dhe “gjithçka” është, së pari, ajo çka ai ka në dorë, për çka “flitet” që bie ende erë bojë e freskët, duke i shkaktuar po atë ndjesi që i shkakton baruti luftëtarit...”.



## 18. A duhet të kërkojë një fillestar ndihmën e një shkrimtari të njohur?

BERNARD CLAVEL

“Shpesh duhen shumë vite e mjaft libra që një shkrimtar të gjejë publikun e vet, por që nga çasti kur ky publik

ekziston, ai shkëputet nga vajzat e djemtë, nga gratë e burrat të cilët kanë, gjithashtu, shijen dhe dëshirën për të shkruar. Meqë duan një autor, meqë ndihen në lidhje të ngushtë me të, atij ia drejtojnë tekstete tyre. Këtij njeriu që ka fatin të botohet e që i lexon librat, ata i veshin të gjithë pushtetet. Edhe ai, nga ana e tij, do t'i lexojë, do t'u japë me doemos dorëshkrimet e tyre botuesit të vet dhe, sapo të dalë ky roman, mjafton që shkrimtari i njohur të lëvizë gishtin e vogël që romancieri çirak të rrëmbejë kreshtën e listës së veprave më të lexuara. Mos o Zot, po të qe pikërisht kështu...! Mirëpo, jo! Kjo gjë nuk bën vaki. Le ta përsërisim sërish: shkrimtari nuk ka asnjë pushtet në këtë fushë, kurse dorëshkrimet u duhen drejtuar botuesve...?”.



## 19. Si të kundërveprosh ndaj shkakimit të botuesve?

CLAUDE MICHELET

“Unë kam shkruar shumë, para se të gjeja një botues. Kështu thyhet dora. Kisha gati tetë a nëntë dorëshkrime, pa patur premtim botimi. Duhet kohë. Edhe në këtë pikë nuk duhet ta humbasësh toruan, në ndodhtë që të marrësh letra mospranimi nga botuesit. Unë kam shumë të këtyllat, madje disa të shkëlqyera, edhe nga botues të famshëm parizianë, sot e kësaj dite. Në këtë rast, një nga të dyja: ose do ta kundërshtosh këtë mospranim e do të hash kokëfortësi, duke mbetur te një dorëshkrim i vetëm, që ua paraqet dhjetë a pesëmbëdhjetë botuesve, ose do ta lësh atë mënjane e do t'i qepesh ndonjë romani tjetër. Unë kam gjetur këtë zgjidhje: pas çdo mospranimi, kam qenë i detyruar, jo ta rimarr temën, por të mblatoj një trajtë të re rrëfimi, sa më vetjake. Tek e fundit, kështu mësojmë të shkruajmë paksa, sepse të shkruarit mësohet”.



## 20. A vjen sukcesi menjëherë?

CHARLES BAUDELAIRE

“Shkrimtarët e rinj, që duke folur me shoshonin, me një theks ziliqar, thonë: “Është fillestar premtues, ka patur një kënaqësi kryeneçe!”, nuk mendojnë që çdo fillesë ka qenë gjithmonë e paraprirë e se është përftim i njëzet fillesave të tjera që ata nuk i kanë njohur. Nuk di ta them nëse në çështje fame, ka qëlluar ndonjëherë shkrepëtimë vetëtime. Më së shumti, besoj që një sukses është në proporcion aritmetik a gjeometrik sipas fuqisë së shkrimtarit, rezultat i sukseseve të mëparshme, shpesh të pakapshme nga syri i pastërvitur...”.



## 21. Cilat janë këshillat e para që mund t'i jepen një poeti në bisk?

MAX JACOB

“Po të kisha sot... gusht 1943, për të mëkuar një poet, unë do t' i thosha:

a) Mos shkruaj me fjalë, shkruaj me sende e me ndjesime (pra: shmang njëherë e mirë çdo ligjërim kritik, çdo ligjërim intelektual, e madje, dhe përshkrimin a thjesht rrëfimin)!

b) Mos shkruaj asnjë fjali në trajtën e paraprirëses, veç në rastin e ndonjë domosdoshmërie të pashmangshme të ritmit të veçantë, por shndërroje sintaksën tënde, siç bënte Shakespeare-i me sintaksën e vet, ruaj këto trajta sintaksike, përfto prej tyre një repertor, një regjistër. Mendimet qasen vetiu, kur kallëpi është gati t' i përthithë. Kjo është e fshehta për të mos mërëzitur kurrë!

c) Dhe, më e rëndësishmja është kjo: një vepër nuk vlen prej asaj çka përmban, por prej asaj çka e qarkon. Lypset që fjalët: “Mirëdita, Mirëmbërma!” të kenë qerthullore një filozofi të pacak të natyrës, shoqërisë, astronomisë, metafizikës e kësodore. Këtu qëndron e fshehta e veprave madhore”.

# GRANT CARDONE

AUTORI BESTSELLER I LIBRIT  
*NËSE NUK JENI I PARI, JENI I FUNDIT*

# 10X

**RREGULLI I VETËM QË  
BËN DALLIMIN NDËRMJET  
SUKSESIT DHE DËSHTIMIT**

Minerva